



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; E-mail: klsh@klsh.org.al*

Nr. Prot. 204/9-10

Tiranë, më 24.09.2021

Miratohet

**Raport Auditimi Performance**  
**"Ekonomia Rurale me fokus Agroturizmin"**

**K R Y E T A R**

**Arben SHEHU**



**Yllka PULASHI**

**Drejtor i Departamentit**

**Publik:** Ky dokument u gjenerua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, specifikisht neni 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3 E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti lutemi të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.

## **RAPORT AUDITIMI**

### **“Ekonomia Rurale me fokus Agroturizmin”**

---

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 204/3 prot., datë 29.04.2021.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 04.02.2021 me shkresën njoftim-fillim auditimi nr. 204/1 prot., datë 04.02.2021 drejtuar AZHBR-së, dhe shkresën nr. 204/1 prot., datë 04.02.2021 drejtuar MBZHR-së.

Projekt-raporti i auditimit mori formë përfundimtare më 22.07.2021 dhe, me shkresën nr. 204/5 prot. dhe 204/6 prot., iu përçoll subjekteve nën auditim, konkretisht MBZHR-së dhe AZHBR-së.

Brenda afatit për observacione nga palët e interesit, subjektet e audituar paraqitën komente mbi projekt-raportin e auditimit, me observacionin nr. 204/6 prot., datë 19.08.2021, të cilat u trajtuan nga grupi i auditimit. Më pas u procedua me hartimin e raportit final të auditimit, i cili u përmirësua nga versioni në projekt-raport, mbështetur mbi thellimin e analizave të gjetjeve, diskutimet me Drejtorin e Departamentit dhe konsultimin e mëtejshëm të dokumenteve dhe bazës ligjore.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:  
Delor Prosi (përgjegjëse e grupit të auditimit);  
Eva Kushta (anëtare);  
Anesti Gjikalaj (anëtar).

Procesi auditues u mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme nga Kryeaudituesi i Departamentit, z. Aulent Guri.

## Përmbajtja

<b>1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT .....</b>	<b>4</b>
1.1 Konteksti i Problemit Social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës .....	4
<b>2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM .....</b>	<b>5</b>
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim .....	5
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim .....	6
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit .....	7
2.4 Pesha në buxhet .....	8
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia .....	10
2.6 Skema e analizës së programit.....	11
2.7 <i>Feedback</i> -u i subjektit në fazën e terrenit.....	13
<b>3.QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT .....</b>	<b>13</b>
3.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit.....	13
3.2 Objektivi i auditimit .....	13
3.3 Piramida e pyetjeve të auditimit .....	14
3.4 Kriteret Audituese.....	15
3.5 Qasja e auditimit .....	15
<b>4.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE AUDITUESE .....</b>	<b>16</b>
A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit? .....	16
4.1 A ka hartuar MBZHR politika që nxisin dhe zhvillojnë agroturizmin? .....	16
4.1.1 A janë hartuar objektivat dhe kuadri ligjor specifik për zhvillimin e agroturizmit? .....	16
4.1.2 A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/arritjen e objektivave? .....	29
4.2 A ka arritur rezultatet e synuara dinamika e zhvillimit të agroturizmit? .....	35
4.2.1 A është garantuar plotësimi i nevojave/kërkesave për zhvillimin e agroturizmit? .....	35
4.2.2 A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizmit dhe a janë arritur rezultatet e synuara? .....	42
<b>5. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>42</b>
<b>6. GRUPI I PUNËS.....</b>	<b>48</b>

# 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

## 1.1 Konteksti i Problemit Social

Shqipëria është një vend bujqësor me pozicion të favorshëm gjeografik, me peizazhe të mrekullueshme, klimë favorizuese dhe me traditë të pasur në kulinari, duke ofruar kështu një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit. Në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe rreth 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 rrethëve do të thotë 1200 sipërmarrje potenciale agroturizmi që presin mundësi investimi gjatë 5 deri në 7 vitet e ardhshme<sup>1</sup>. Aktualisht, sektori i agroturizmit është duke u mbështetur me grante nga fondet IPARD të BE-së dhe Programi Kombëtar i Granteve i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR). Të dyja programet menaxhohen nga AZHBR, duke ofruar mbështetje me grante për projektet e investimeve në agroturizëm dhe turizmin rural.

Megjithëse fenomeni i globalizimit ka siguruar mundësi për ndërmarrjet e mëdha, nga ana tjetër, fermat e vogla dhe komunitetet rurale kanë mbetur jashtë fokusit. Kohët e fundit, agroturizmi konsiderohet si një ndërmarrje e re rurale që mund të nxisë zhvillimin rural. Kjo strategji e diversifikimit të aktiviteteve në fermë, mund të rrisë punësimin, të mbrojë peisazhet, parandalon shpopullimin, siguron teknika më të qëndrueshme të prodhimeve të fermave. Agroturizmi përfaqëson një strategji zhvillimi për zonat rurale dhe një burim të rëndësishëm të ardhurash, veçanërisht për fermat e vogla dhe të mesme. Për më tepër, agroturizmi ka tërhequr vëmendjen e politikëbërësve sepse konsiderohet katalizator për zhvillimin rural, veçanërisht në zonat bujqësore që kanë përjetuar rënie. Si rezultat, me përqendrimin e tij të fortë në kapitalin njerëzor dhe burimet financiare, agroturizmi është një katalizator i besueshëm i politikave për zhvillimin e komuniteteve rurale.

Zhvillimi i këtij sektori ka qenë dinamik vitet e fundit ndërkohë që trajtohet nga programet e qeverisë si një sektor me prioritet të lartë. Me gjithë rëndësinë që i kushtohet sektorit të agroturizmit në strategji të ndryshme të qeverisë, akoma nuk ka një strategji kombëtare të dedikuar për zhvillimin e këtij sektori mbështur edhe në praktikatat më të mira të vendeve të rajonit. Pavarësisht potencialit, ky sektor haset në disa kufizime, siç është infrastruktura rrugore dhe transporti jo i përshtatshëm publik, që pengon rritjen e kërkesës, ose niveli i ulët i arsimit në zonat rurale, që mund të sjellë mungesë në staf të kualifikuar.

## 1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i Performancës është konceptuar në Strategjinë 2018 – 2022 si një nga dy shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sfidë madhore në rritjen e rolit auditues suprem në Shqipëri dhe e ardhmja e natyrshme institucionale, në linjë kjo me eksperiencat botërore. Performanca është rritur shëndetshëm gjatë 5-vjeçarit të kaluar, duke e bazuar punën e saj në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në këtë kontekst zhvillimor institucional, misioni i departamentit në kuadër të punës audituese është: *promovimi i përmirësimeve në performancën e të mirave publike*.<sup>2</sup>

Pikërisht duke pasur parasysh misionin e departamentit është propozuar edhe tema mbi ekonominë rurale me fokus agroturizmin, e cila synon trajtimin shterues të problematikave kryesore që ndeshen në fushën e promovimit, nxitjes dhe zhvillimit të agroturizmit, parë nga perspektiva e një mundësie potenciale.

Për më tepër, duhet theksuar këtu se fusha e ekonomisë rurale ka qenë në fokusin e veçantë, jo vetëm të Departamentit të Auditimit të Performancës, por edhe atë institucional, nisur edhe nga fakti se sistemi i ekonomisë rurale në vendin tonë ende është në fazë zhvillimi dhe modernizimi, e

<sup>1</sup> Studim nga Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF - Sektori i agroturizmit në Shqipëri: Potencialet për zhvillim dhe nevojat financiare.

<sup>2</sup> Manuali Departamentit të Auditimit të Performancës fq. 1.

për rrjedhojë auditimi i jashtëm publik mund të zhvillojë maksimalisht impaktin e tij rekomandues në funksion të përmirësimit të situatës.

## **2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM**

### **2.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

Në nivel ndërkombëtar, zhvillimi i ekonomisë rurale shihet si një nga komponentët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Pikërisht, lidhur me këtë, është miratuar VKM nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”. Kjo strategji ka në fokus fushat e politikave që janë përcaktuar për të arritur objektivat e përgjithshme, si më poshtë:

- Ndërhyrje për zhvillimin rural;
  - Ndërhyrje kombëtare që lidhen me mbështetjen e të ardhurave të fermerëve, zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe garantimin e shanseve të barabarta;
  - Zhvillimi institucional, legjislacioni dhe zbatimi i tij;
  - Norma e rritjes reale ekonomike e sektorit bujqësor me deri në 5% deri në vitin 2020;
  - Rritja e produktivitetit të punës në bujqësi me të paktën 8% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;
  - Rritja e produktivitetit të punës në agropërpunim me të paktën 5% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;
  - Sjellja e të gjitha fermave dhe e operatorëve agropërpunues të regjistruar në përputhje të plotë me standardet e BE-së deri në vitin 2020;
  - Rritja e përmasës mesatare të fermës në të paktën 2,5 ha në vitin 2020; dhe rritja e përmasës mesatare të fermave tregtare në 3,5 ha;
  - Përmirësimi i organizimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet krijimit të 100 shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe llojeve të ngjashme të bashkëpunimit të fermerëve në vitin 2020;
  - Përmirësimi i raportit eksport-import në raport 1:3 në vitin 2020;
  - Krijimi i një sistemi institucional të plotë dhe gjithëpërfshirës të MBZHRAU-së, i një kuadri rregullator dhe një sistemi të duhur zbatimi në përputhje me BE-në dhe PPB-në;
  - Krijimi i 9000 vendeve pune në aktivitetet e përpunimit agroushqimor në periudhën 2012 - 2020;
  - Krijimi i 50-100 mikrondërmarrjeve dhe i 500–1000 vendeve të reja pune në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që sjellin të ardhura;
  - Krijimi i 5000 vendeve pune në aktivitete jobujqësore dhe shërbime të tjera.
- MBZHR është institucioni politikëbërës dhe më i lartë përgjegjës për fushën e zhvillimit rural dhe ka nën varësinë e saj Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, si institucion politikëzbatues. Ajo harton dhe ndjek strategjitë kombëtare të zhvillimit rural në Republikën e Shqipërisë. Lidhur me monitorimin, analizimin dhe zërthimin e politikave e strategjive të hartuara nga MBZHR, është krijuar me VKM. Nr. 1443 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR). Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural koncepton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Misioni i MBZHR është të hartojë dhe zbatojë politika që synojnë mbështetjen e rritjes së qendrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, të hartojë dhe të përafrojë legjislacionin në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural, të mbledhë e të përpunojë informacionin bujqësor, të ofrojë asistencë dhe informacion për fermerët.
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka nisur aktivitetin e tij më 30.12.2008. AZHBR ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor. AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural.

## 2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2014-2020;
- Ligji nr. 9817 datë 22.07.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2014-2020;
- VKM nr. 719 datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- VKM nr. 137 datë 22.02.2017, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2017”;
- VKM Nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”.
- VKM nr. 72 datë 07.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2018”;
- VKM nr. 546 datë 19.09.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 72 datë 07.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2018”, të ndryshuar”;
- VKM nr. 128 datë 13.03.2019, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019”;
- VKM nr. 184 datë 04.04.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 128 datë 13.03.2019, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019”;
- VKM nr. 100 datë 05.02.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020”;
- VKM nr. 1102 datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2021”;
- Urdhër nr. 311 Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 09.09.2019 për “Miratimin e rregullores mbi funksionimin e Komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i certifikatës paraprake”, i ndryshuar me Urdhrin 32 datë 26.01.2021;
- Urdhër nr. 312 Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 09.09.2019 për “Miratimin e modelit të certifikatës paraprake, certifikatës “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit” dhe shenjës dalluese”;
- Urdhër nr. 323 Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 18.09.2019 për “Ngritjen e komisionit të vlerësimit “certifikatë paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm” dhe certifikatë “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit”;
- Udhëzim nr. 8 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 31.03.2017, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 10 datë 22.05.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin, nr. 8 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë, datë 31.03.2017 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;

- Udhëzim nr. 1 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 19.02.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 11, i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë datë 21.06.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1 datë 19.02.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 14 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë datë 28.09.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1 datë 19.02.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, i ndryshuar;
- Udhëzim nr. 3/1 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 15.04.2019, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 5 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 07.06.2019, “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 3/1 datë 15.04.2019, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 3 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 24.02.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 3/1 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 12.03.2020, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 24.02.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Udhëzim nr. 3/2 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 13.05.2020, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 24.02.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar;
- Udhëzim nr. 3/3 i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 08.09.2020, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 24.02.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor 2019 dhe Rural nr. 97/1 Prot. datë 21.02.2019 miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Rregullore e brendshme e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2020, Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 13, datë 5.10.2020 botuar në fletoren zyrtare nr. 178/2020;
- Raporte vjetore të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;
- Raporte nga organizata ndërkombëtare (GIZ, SWG, FAO).

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Ligji nr. 9817 datë 22.07.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” ka përcaktuar objektivat, masat dhe programimin e politikave bujqësore e të zhvillimit rural, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionit për politikën në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural. Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ka si qëllim të mbështesë

zhvillimin e bujqësisë në vend, si dhe të garantojë efektivitetin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke i dhënë një rëndësi të lartë fushës së Agroturizmit.

Institucionet e përzgjedhura si objekt auditimi janë të lidhura drejtpërdrejtë me politikëbërjen dhe ofrimin e shërbimeve për realizimin e mekanizmave të parashikuar për zhvillimin e agroturizmit dhe ekonomisë rurale. Konkretisht:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural koncepton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Misioni i MBZHR është të hartojë dhe zbatojë politika që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, të hartojë dhe të përafrojë legjislacionin në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural, të mbledhë e të përpunojë informacionin bujqësor, të ofrojë asistencë dhe informacion për fermerët.
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor. AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, fondeve të buxhetit të shtetit; fondeve kundërparti, fondeve të projektit 2KR; fondeve të Bashkimit Evropian; si dhe fondeve të siguruara nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri. AZHBR ka për detyrë të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, orientimit të veprimtarisë së fermerëve; zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme; të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë; të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit; të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme; të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut; të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.


#### **2.4 Pesha në buxhet**

Fondet buxhetore për agroturizmin gjatë periudhës objekt auditimi 2018-2020, kanë pësuar një ulje të ndjeshme. Me gjithë përpjekjet e bëra për zhvillimin e agroturizmit nga analiza e të dhënave të deritanishme vihet re mungesa e fokusit, agroturizmi nuk rezulton të jetë pjesë e një strategjie të dedikuar, për pasojë nuk ka parashikime dhe të dhëna që tregojnë planifikimin afatgjatë të burimeve të financimit dhe tendencën e tyre.

Gjatë periudhës 2018-2020 fondet e planifikuara për masën e agroturizmit janë 206.684.210 lekë në raport me fondet e planifikuara për masat mbështetëse nëpërmjet skemës kombëtare në vlerën 3.659.504.000 lekë.


Duhet theksuar se mbështetja për sektorin e agroturizmit kryhet edhe nëpërmjet Programit IPARD në masën 75% të investimit dhe përgjatë periudhës objekt auditimi ka patur 2 thirrje për aplikime nga ky program.

**Tabela nr.1** Pesha specifike që zënë fondet e përdorura për zhvillimin e agroturizmit në raport me buxhetin total të Programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, mesatarisht për periudhën 2018-2020.




**Tabela nr.2** Raporti mes fondeve të përdorura për zhvillimin e agroturizmit në raport me buxhetin total (parashikimin) të Programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për periudhën 2018-2020.

	<b>Buxheti i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Plan)</b>	<b>Buxheti për Agroturizmin(Plan)</b>
Viti 2018	1,804,162,000	143,494,470
Viti 2019	711,392,000	54,134,354
Viti 2020	1,143,950,000	9,055,386




**Tabela nr.3** Raporti mes fondeve të përdorura për zhvillimin e agroturizmit plan me realizimin, për periudhën 2018-2020

	<b>Buxheti për Agroturizmin Plan</b>	<b>Buxheti për Agroturizmin (Realizimi)</b>
Viti 2018	143,494,470	99,052,429
Viti 2019	56,522,530	45,154,237
Viti 2020	9,055,386	9,045,750



**Tabela nr.4** Tendenca e fondeve të përdorura për zhvillimin e agroturizmit për periudhën 2018-2020.



## 2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

- “Agroturizëm” është veprimtaria pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor;
- “Bujqësia” është veprimtaria ekonomike, e cila ka si objektiv prodhimin e ushqimit për njerëzit, të ushqimit për blegtorinë, të bimëve industriale dhe të karburanteve bio, si dhe të produkteve të tjera, nëpërmjet kultivimit sistematik të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve.
- “Fermë” është njësia ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen të. Është një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral.
- “Produkt bujqësor” është një produkt bimor apo shtazor, i cili prodhohet në fermë, si dhe produktet që rrjedhin nga faza e parë e përpunimit të këtij produkti bimor apo shtazor.


- “Produkt agroushqimor” është produkti bujqësor dhe produkte të tjera ushqimore të përpunuara.
- “Politikat bujqësore” janë politika shtetërore, që përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agroushqimore dhe të ardhurat nga ferma.
- “Politikë e zhvillimit rural” është një politikë shtetërore, që përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, në konvergjencën e tyre ekonomike dhe sociale, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.
- “Plani Kombëtar” është plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- “Plani i veprimit” është plani i veprimit të zbatimit të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.
- “Strategjia e bujqësisë dhe strategjia e zhvillimit rural” janë objektivat afatmesme të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, programimi, masat dhe mënyrat se si Qeveria planifikon mbështetjen financiare në një periudhë kohore të dhënë, në të mirë të bujqësisë dhe zonave rurale.
- “Plan veprimi” është dokumenti i programimit, që përshkruan se si Qeveria do të zbatojë strategjitë në zona të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore.
- “Masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural” janë instrumentet ligjore dhe financiare për arritjen e objektivave, në përputhje me dokumentet programuese.
- “Zonat më pak të favorizuara” janë zona malore ose zona të tjera, ku pozicioni gjeografik dhe pengesat natyrore rezultojnë në koston e lartë të prodhimit.

## **2.6 Skema e analizës së programit**

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e efikasitetit të mekanizmave për mbështetjen e agroturizmit, rolin që të subjektet e auditimit kanë patur në politikëbërje dhe në zbatim të masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, orientimit të veprimtarisë së fermerëve; zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme në kuadër të zhvillimit të ekonomisë rurale duke u fokusuar veçanërisht në:

- zbatimin dhe monitorimin e strategjisë;
- ndarjen e roleve ndërmjet subjekteve;
- mënyrat e përfitimit të fondeve mbështetëse;
- krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave të nevojshme;
- organizimi i ngritjes dhe zbatimit të sistemeve të informimit të tregut;
- monitorimi i fermerëve dhe subjekteve, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural

**Tabela nr. 5** Skema e analizës së programit



## **2.7 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit**

Gjatë fazës së terrenit, MZHBR dhe AZHBR i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese dhe plotësimi të informacionit të kërkuar, kryesisht dokumentacionin që lidhet me bazën ligjore, historikun, strukturën e subjekteve, etj., si dhe janë përgjigjur në kohë pyetësorëve të hartuar nga grupi i auditimit për këtë fazë.

MBZHR ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, shoqëruar me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

AZHBR ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas rastit edhe në format elektronik. Vlen të theksohet gatishmëria gjatë komunikimeve që grupi i auditimit ka patur me këtë subjekt për çështje të ndryshme që lidhen me temën e auditimit. Gjithashtu grupi i auditimit është asistuar nga punonjës të AZHBR-së gjatë vizitave në terren në disa nga subjektet përfitues të skemave kombëtare.

## **3.QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT**

### **3.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit**

Agroturizmi shihet si një sektor me potencial të lartë zhvillimi në vendin tonë. Duke qenë se është një sektor i futur rishtaz, u zgjodh të kryhet ky auditim performance, për të parë hapat që kanë ndërmarrë institucionet shqiptare për garantimin e zhvillimit të tij.

Kryesisht, auditimi është fokusuar në:

- Politikat kombëtare për zhvillimin e agroturizmit, si dhe ndarjen e detyrave, roleve e përgjegjësive mes aktorëve të përfshirë;
- Skemat kombëtare të mbështetjes për zhvillimin bujqësor e rural.

Për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të agroturizmit, është e nevojshme të kemi një strategji të mirëfilltë, duke patur kështu një menaxhim sipas objektivave, si dhe një bazë ligjore që rregullon çdo gjë në lidhje me sektorin e agroturizmit, duke ndarë qartë detyrat, rolet e përgjegjësitë mes aktorëve.

Që prej vitit 2018, në Skemat Kombëtare është përfshirë si një masë e veçantë “Agroturizmi”, duke mbështetur subjektet që kanë zgjedhur të diversifikojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor.

Auditimi synon të trajtojë aktivitetin e subjekteve, me qëllim evidentimin e problematikave të mundshme që mund të çenojnë shfrytëzimin e potencialit të lartë që ky sektor ka dhe të japë rekomandime për të përmirësuar performancën e subjekteve, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

### **3.2 Objektivi i auditimit**

Sektori i agroturizmit, në të cilin është hasur potencial i madh zhvillimi, është në fillesat e veta në Shqipëri. Gjatë kryerjes së auditimit, objektivi kryesor ishte matja e performancës së institucioneve përgjegjëse në fushën e agroturizmit, zbatimin e politikave për zhvillimin e agroturizmit, monitorimin e zbatimit të tyre, impaktin që ka sjellë mbështetja në sektorin e agroturizmit, pra efektivitetin e mekanizmit të krijuar për zhvillimin e agroturizmit.

Duke patur në vëmendje objektivin e sipërcituar, grupi i auditimit ka hartuar edhe piramidën e pyetjeve audituese, e cila nëpërmjet nënpyetjeve të nivelit të parë e të dytë, mbulon mekanizmin e zhvillimit të agroturizmit, që është përcaktuar si objektivi i këtij auditimi.

### 3.3 Piramida e pyetjeve të auditimit

**A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?**

**A ka hartuar MBZHR politika që nxisin dhe zhvillojnë agroturizmin?**

**A ka arritur rezultatet e synuara dinamika e zhvillimit të agroturizmit?**

**A janë hartuar objektivat dhe kuadri ligjor specifik për zhvillimin e agroturizmit?**

**A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/ arritjen e objektivave?**

**A është garantuar plotësimi i nevojave/kërkesave për zhvillimin e agroturizmit?**

**A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizmit dhe a janë arritur rezultatet e synuara?**

### 3.4 Kriteret Audituese

Pyetja Kryesore	Pyetjet e nivelit të parë	Pyetjet e nivelit të dytë	Kriteret Audituese	Referenca e kriterëve
A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?	A ka hartuar MBZHR politika që nxisin dhe zhvillojnë agroturizmin?	A janë hartuar objektivat dhe kuadri ligjor specifik për zhvillimin e agroturizmit?	KA1. Përcaktimi i objektivave strategjike në dokumente strategjike	Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural 2014-2020
		A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/ arritjen e objektivave?	KA2. Ndarja e përgjegjësisë midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	Pikat 3,4,5 VKM nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar. Neni 2, 18 Rregullorja e Brendshme e MBZHR; Neni 3 Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”
	A ka arritur rezultatet e synuara dinamika e zhvillimit të agroturizmit?	A është garantuar plotësimi i nevojave/kërkesave për zhvillimin e agroturizmit?	KA3. Fondet e parashikuara për agroturizmin në Skemat Vjetore të Mbështetjes	VKM “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, VKM del në fillim të çdo viti dhe përcakton sasinë e fondeve që do të shkojnë mbështetjen e secilës masë, një prej të cilave është <i>agroturizmi</i> .
		A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizmit dhe a janë arritur rezultatet e synuara?	KA4. Inspektimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve të përfituara për agroturizëm, monitorimi i zbatimit të politikave dhe matja e efektivitetit të këtyre politikave	Pika 5.b & 5.e VKM nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar. Monitorimi i zbatimit të politikave nga ana e MBZHR, Rregullorja e Brendshme e MBZHR

### 3.5 Qasja e auditimit

Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit ka grumbulluar dokumente mbi temën objekt auditimi, të dhëna për vitet 2018-2020, si dhe ka realizuar intervista me punonjës që mbulojnë sektorë të ndryshëm në MZHBR dhe AZHBR. Gjithashtu për të marrë informacion më të detajuar u zhvilluan pyetësor me 2 subjektet objekt auditimi si edhe intervista me disa nga fermerët përfitues të skemave kombëtare. Bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, qasja audituese që u aplikua ishte qasja pragmatike. Kjo qasje si një qasje mikse e qasje sasiore dhe cilësore u përdor për të analizuar problemet e konstatuara nga grupi i auditimit mbi mekanizmin e ngritur për zhvillimin e agroturizmit. Grupi pasi analizozi evidencat e

grumbulluara i krahasoi ato kundrejt kriterëve të paravendosura për të arritur kështu në përfundimet përkatëse dhe të bazuara në evidencat e auditimit.

#### 4.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE AUDITUESE

**A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?**

**4.1 A ka hartuar MBZHR politika që nxisin dhe zhvillojnë agroturizmin?**

**4.1.1 A janë hartuar objektivat dhe kuadri ligjor specifik për zhvillimin e agroturizmit?**

➤ **Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020**

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (në vijim SNZHRB), e miratuar me VKM nr. 709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”, cilësohet si dokumenti kryesor politik që rregullon zhvillimin e sektorit të agroturizmit. SNZHRB është hartuar sipas kuadrit të strategjisë “Europa 2020” për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse të objektivit të përgjithshëm strategjik të Shqipërisë për t’u anëtarësuar në BE. Ajo është përgatitur në përputhje me qasjen për planifikim strategjik në BE për Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) 2014-2020, duke u përqendruar në të njëjtën kohë në nevojat specifike për zhvillimin e bujqësisë, të agropërpunimit dhe zonave rurale në Shqipëri. Këto nevoja dhe sfida janë bazuar dhe analizuar përmes disa studimeve sektoriale dhe analizave të kryera si pjesë e procesit të përgatitjes së strategjisë.



*Burimi: Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural*

Disa nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e turizmit në zonat rurale në Shqipëri, të evidentuara në SNZHRB, janë:

- Infrastruktura;
- Zhvillimi i pamjaftueshëm i ambienteve dhe atraksioneve turistike;
- Informacionet dhe shërbimet turistike të kufizuara;
- Burimet njerëzore të trajnuara, etj.

Për të minimizuar ndikimin që sjellin këto pengesa në zhvillimin e turizmit në zonat rurale, Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor përcakton se “*MBZHRAU-ja do të përgatisë një plan veprimi që do të përshkruajë veprimet (aktivitetet) specifike që do të ndërmerren në periudhën afatshkurtër (2014 dhe 2015), në periudhën afatmesme (2016-*

2020) dhe në periudhën afatgjatë (pas vitit 2020) dhe ky plan veprimi do t'i bashkëlidhet strategjisë<sup>3</sup>.

Infrastruktura është një nga faktorët më të rëndësishëm për rritjen rurale. Ajo ndikon në kushtet e prodhimit dhe të jetesës, qasjen në treg, mundësitë e gjenerimit të të ardhurave jashtë fermës dhe tërheqjen e investimeve. Në përgjithësi, mangësitë infrastrukturore janë disi të larta në zonat rurale. Zonat rurale kanë infrastrukturë dhe shërbime publike pak të zhvilluara dhe me nivel të ulët mirëmbajtjeje (transporti, energjia elektrike dhe uji i rrjedhshëm, arsimi, kujdesi shëndetësor etj.), si në lidhje me cilësinë, ashtu edhe me mbulimin. Banorët e zonave të thella rurale shpesh përmendin mungesën e infrastrukturës thelbësore si faktorin kryesor të pafavorshëm dhe si një përcaktues domethënës në standardin e tyre të ulët të jetesës. Në dekadën e fundit, shërbimet e telefonisë celulare dhe fikse janë përmirësuar dukshëm në Shqipëri si në zonat urbane, dhe në ato rurale. Gjithashtu shërbimi i energjisë elektrike është përmirësuar që prej fundit të vitit 2000. Ndërprerjet e energjisë elektrike (të cilat ishin problem jo vetëm për jetën e përditshme të familjeve, por gjithashtu edhe për aktivitetet bujqësore dhe agropërpunuese) janë më të rralla në ditët e sotme në zonat rurale.

Për të rritur kapacitetet institucionale të MBZHR-së dhe AZHBR-së, janë planifikuar disa aktivitete, nëpërmjet zhvillimit të Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit, për të përmbushur kërkesat e BE-së.

**Komponentët kryesorë të këtyre aktiviteteve janë si vijon:**

- Krijimi i sistemit të identifikimit të parcelave të tokës (LPIS);
- Krijimi i regjistrit të plotë të fermave;
- Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave të zbatimit të masave për zhvillimin rural.

Këto aktivitete, në SNZHRB, ishin planifikuar të fillonin në vitin 2014, *por deri më tani nuk ka një sistem të identifikimit të parcelave të tokës, si dhe ende nuk është krijuar një regjistër i plotë i fermave.*

Vizioni për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri do të mbështesë dhe zhvillojë kushtet e kuadrit të duhur për një sektor agroushqimor efikas, novator dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të BE-së përmes një shfrytëzimi të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave rurale produktive, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi jetese për banorët në zonat rurale.

**Për të arritur këto objektiva të përgjithshme janë përcaktuar këto fusha politikash:**



Ndërhyrje për zhvillimin rural



Ndërhyrje kombëtare që lidhen me mbështetjen e të ardhurave të fermerëve, zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe garantimin e shanseve të barabarta



Zhvillimi institucional, legjislatiioni dhe zbatimi i tij

*Burimi: Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural*

<sup>3</sup> Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020, fq. 3, Përmbledhja ekzekutive

### Objektivat e matshme kryesore të politikave, të parashikuara në SNZHRB, janë:

- Norma e rritjes reale ekonomike e sektorit bujqësor me deri në 5% deri në vitin 2020;
- Rritja e produktivitetit të punës në bujqësi me të paktën 8% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/ të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;
- Rritja e produktivitetit të punës në agropërpunim me të paktën 5% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;
- Sjellja e të gjitha fermave dhe e operatorëve agropërpunues të regjistruar në përputhje të plotë me standardet e BE-së deri në vitin 2020;
- Rritja e përmasës mesatare të fermës në të paktën 2,5 ha në vitin 2020; dhe rritja e përmasës mesatare të fermave tregtare në 3,5 ha;
- Përmirësimi i organizimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet krijimit të 100 shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe llojeve të ngjashme të bashkëpunimit të fermerëve në vitin 2020;
- Përmirësimi i raportit eksport-import në raport 1:3 në vitin 2020;
- Krijimi i një sistemi institucional të plotë dhe gjithëpërfshirës të MBZHRAU-së, i një kuadri rregullator dhe një sistemi të duhur zbatimi në përputhje me BE-në dhe PPB-në;
- Krijimi i 9000 vendeve pune në aktivitetet e përpunimit agroushqimor në periudhën 2012 - 2020;
- Krijimi i 50-100 mikrondërmarrjeve dhe i 500– 1000 vendeve të reja pune në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që sjellin të ardhura;
- Krijimi i 5000 vendeve pune në aktivitete jobujqësore dhe shërbime të tjera.

Nga monitorimi i SNZHRB, nga ana e MBZHR, ka rezultuar, si më poshtë:

Indikatorët	2012	Target 2017	Fakt 2018	Fakt 2019	Parashk . 2020	Target 2020
<b>Tokë bujqësore (ha)</b>	696,000	<b>696,000</b>	696,000	696,000	696,000	<b>696,000</b>
<b>Tokë e shfrytëzuar bujqësore, % e totalit</b>		<b>75</b>	72.0	72.0	72.0	<b>80</b>
<b>Përmasa e fermës (ha)</b>	1.2	<b>2</b>	2.0	2.0	2.0	<b>3</b>
<b>Të punësuar në agropërpunim</b>	11,407	<b>15,000</b>	13,277	14,163	13,862	<b>20,000</b>
<b>Produktiviteti i punës në agropërpunim (GVA/Awwu, rritja vjetore ne % (vlerë nominale)</b>	3.0	<b>4.5</b>	5.1	4.9	4.9	<b>5.0</b>
<b>Eksporti i produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit, milionë lekë</b>	12,982	<b>33,000</b>	33,827	36,615	40,151	<b>50,000</b>
<b>Importi i produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit, milionë lekë</b>	87,492	<b>120,000</b>	111,678	118,171	118,046	<b>150,000</b>
<b>Raporti eksport – import</b>	1:7	<b>1:4</b>	1:3.3	1:3.2	1:2.9	<b>1:3</b>
<b>Numri i fermave organike</b>		<b>600</b>	71	81	81	<b>1000</b>
<b>Sipërfaqja potenciale e ujitur (ha)</b>	360,000	<b>360,000</b>	360,000	360,000	360,000	<b>360,000</b>
<b>Tokë bujqësore e përmirësuar dhe rehabilituar</b>	220,000	<b>250,000</b>	235,000	245,000	255,000	<b>290,000</b>

% e femrave përfituese nga shërbimi këshillimor	10	15	15	15	15	20
---	----	----	----	----	----	----

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nëse bëjmë një analizë të ndërtimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020 sipas kriterëve SMART (*Specific, Measurable, Achievable, Realist, Timely*), mund të vëmë re se jo të gjitha këto kriterë plotësohen. Në informacionin mbi monitorimet e kryera mbi SNZHRB, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion një analizë e hollësishme, me shkaqet që kanë bërë që disa nga këto indikatorë të mos arrihen.

Duke qenë se zhvillimi bujqësor dhe rural është parë me prioritet nga politika qendrore e lokale, por duke qenë dhe një sektor dinamik, fakti që kjo strategji është hartuar në vitin 2014 dhe mospasja e planeve vjetore të veprimit, i ka çënuar edhe *koherencën* e strategjisë.

Agroturizmi është një sektor i ri dhe me potencial të madh zhvillimi, por ne e gjejmë të përmendur jo më shumë se 3 herë brenda SNZHRB, që e kishte shtrirjen kohore nga viti 2014 deri në vitin 2020, e ndaj sektori i agroturizmit nuk përfshihet në mënyrë direkte në asnjë indikator të matshëm në atë strategji.

Një nga masat e parashikuara në SNZHRB, që është edhe masa e vetme në të cilën përmendet agroturizmi, është masa 10 “*Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit*”. Objektivi i kësaj mase është nxitja e punësimit, nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës dhe ruajtjes së vendeve ekzistuese të punës, përmes zhvillimit të aktiviteteve të reja të biznesit, duke rritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale dhe duke përmbysur trendin aktual të shpopullimit të zonave rurale.

Masa ka si qëllim *diversifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në zonat rurale*, ku përfshihet, Mbështetja për investimet e vogla në ferma:

- Për të filluar aktivitete të tjera ekonomike që nuk lidhen direkt me aktivitetin bujqësor, si p.sh. përpunimi në fermë dhe tregtimi i produkteve të tyre në portën e fermës, *agroturizmi* dhe veprimet (aktivitetet) shoqëruese (kalërimi, peshkimi, gjuetia), si edhe prodhimi i energjisë së rinovueshme etj.

#### **Kushtet kuadër për zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit bujqësor**

Për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale dhe për zbatimin e objektivave dhe prioritetëve të parashtruara në strategji është thelbësor një kuadër ligjor i qëndrueshëm dhe transparent dhe institucionet efikase për zbatimin e legjislacionit.

Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” përbën themelin e këtij kuadri ligjor. Në SNZHRB thuhet se Ligji do të rishikohet me qëllim lehtësimin e zhvillimit strukturor të sektorit të bujqësisë dhe përafrimin me BE-në nëpërmjet iniciativave të mëposhtme:<sup>4</sup>

- Regjistrimi i fermerëve në regjistrin e fermës dhe regjistra të tjerë përkatës (regjistri i kafshëve, LPIS38 etj.). Nismat për regjistrimin e fermerëve dhe për përmbushjen e ligjeve dhe standardeve kombëtare nga ana e tyre do të sigurohen nëpërmjet masave mbështetëse. Vetëm fermerët që përmbushin këto dispozita do të mund të përfitojnë mbështetje.
- Futja e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollit (IACS).
- Prezantimi i parimeve të menaxhimit kontabël dhe ekonomik në ferma. Nismat që fermerët të fillojnë zbatimin e këtyre parimeve do të sigurohen nëpërmjet shërbimeve këshillimore dhe nëpërmjet trajnimeve/transferimit të njohurive.

Referuar Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, i nxjerrë në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Menaxhimi sipas objektivave (MsO) është procesi i përcaktimit të objektivave brenda organizatës në mënyrë

<sup>4</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020, Kapitulli 3.3.1, fq. 56

që menaxhimi dhe punonjësit së bashku të bien dakord për objektivat dhe të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë në organizatë, që t'i arrijnë ato. Një pjesë e rëndësishme e MsO është matja dhe krahasimi i punës aktuale të punonjësit me planin e punës. Idealisht, kur vetë punonjësit janë të përfshirë në vendosjen e objektivave dhe përzgjedhjen e veprimeve për t'u ndërmarrë prej tyre, ka më shumë gjasa që ata të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

Një nga përgjegjësitë për zbatimin e MsO është rënia dakord për strategjinë (planin e punës) e performancës (burimet, synimet, arritjet). Kjo strategji përmban informacion në lidhje me burimet njerëzore dhe financiare, objektivat e përcaktuara nga organi i menaxhimit të buxhetit, si dhe masat dhe veprimet që kërkohen për arritjen e këtyre objektivave. Strategjia mund të jetë për një vit ose shumëvjeçare dhe rinovohet çdo vit. Në procesin vjetor të rinovimit të dakortësisë për strategjinë e performancës, duhet të bëhet një krahasim midis planit dhe realizimit, prandaj është e këshillueshme të bihet dakord për treguesit e performancës, masat dhe dimensionet financiare brenda kësaj strategjie për të gjetur prova për progresin në lidhje me arritjen e objektivave (objektiva SMART).

### ➤ **Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, “Programi i 100 fshatrave”**

Me VKM nr. 21, datë 12.01.2018 “Për disa shtesa në VKM nr. 709, datë 29.10.2014”, u miratua *Programi i Integruar për Zhvillimin Rural*, siç njihet ndryshe “Programi i 100 fshatrave”, si një nga nismat më të rëndësishme publike të ndërmarrë në drejtim të zhvillimit të agroturizmit, një nismë që synon të krijojë modelin e parë të suksesshëm të zhvillimit të integruar rural në Shqipëri. Qëllimi i këtij programi është që në çdo bashki të ketë të paktën dy fshatra të cilat plotësojnë të gjitha standardet infrastrukturore dhe sigurojnë një nivel të kënaqshëm mirëqenieje për fermerët vendas, të cilat do të përfitojnë nga potencialet e pashfrytëzuara të agroturizmit.

PIZHR-ja do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara (100 fshatra), nëpërmjet 3 objektivave, si më poshtë vijon:



a) Përmirësimi i infrastrukturës publike konsiston në mbështetjen për infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/ urbane, infrastrukturë komunitare, shërbime publike, infrastrukturë mjedisore, turistike, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra multifunkionale komunitare, peizazhi mjedisor etj.;

b) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike konsiston në përmirësimin e potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investime në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbime të tjera ekonomiko-financiare etj.;

c) Zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor konsiston në mbështetjen për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit, si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe të jetesës në fshat etj.

Shumica e njëjësive të qeverisjes vendore (NjQV-të) në Shqipëri i kanë kushtuar vëmendje agroturizmit gjatë zhvillimit të strategjive të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Procesi i mekanizimit në bujqësi së shpejti do të rezultojë në uljen e nevojës për fuqi punëtore dhe

NjQV-të besojnë fuqimisht te agroturizmi si një mundësi për diversifikimin rural, i cili mund të sigurojë të ardhura të qëndrueshme dhe të krijojë punësim duke e kompensuar efektin e mekanizimit të bujqësisë. Impakti i përgjithshëm që synon të arrijë Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) do të matet me treguesit, si më poshtë. Në hapësirën e përcaktuar të 100 fshatrave, PIZHR-ja synon të arrijë:

	<b>Treguesit</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>Totali</b>
1.	Nr. i vendeve të reja të punës	100	200	300	600
2.	Nr. i të punësuarve gra/ vajza	30	50	100	180
3.	Nr. i të punësuarve të rinj (22-35 vjeç)	50	50	100	200
4.	Nr. i bizneseve të reja ( <i>start up</i> ) të mbështetura për të rinj	50	50	50	150
5.	Nr. i bujtinave të mbështetura	50	50	50	150
6.	Nr. i inkubatorëve të ngritur të produkteve tradicionale	5	10	20	35
7.	Nr. i mbështetur i sipërmarrjeve të reja agroturizëm	7	10	10	27
8.	Nr. i sipërmarrjeve prodhuese të produkteve tradicionale	10	15	25	50
9.	Nr. i projekteve të realizuara të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike	30	70	100	200

*Burimi: VKM nr. 21, datë 12.01.2018*

Në kuadër të programit të 100 fshatrave, një nga projektet strategjike, të cilat do të zbatohen me prioritet të lartë, është **krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar**. Agroturizmi dhe turizmi rural janë veprimtari të cilat kanë një potencial të lartë zhvillimi për zonat rurale në Shqipëri dhe tashmë në shumë fshatra të Shqipërisë kanë filluar të funksionojnë ferma që ofrojnë shërbime në agroturizëm dhe kanë arritur në një kohë të shkurtër rezultate shumë të mira ekonomike dhe sociale (Thethi, Voskopoja, Dardha etj.).

Në kuadër të programit të 100 fshatrave do të mbështetet me instrumente financiare dhe fiskale krijimi i një rrjeti fermash agroturistike, që plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara, të cilat do të jenë baza e rrjetit shqiptar të agroturizmit. Mbështetja për të krijuar një masë kritike të numrit të sipërmarrjeve të agroturizmit në Shqipëri do të shërbejë për rritjen e punësimit në zonat rurale, krijimin e një destinacioni dhe “marke” të veçantë të agroturizmit në Shqipëri, krahas ofertave të tjera turistike, si dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerave tradicionale të fshatit shqiptar.

Programi do të synojë mbështetje për rreth 27 sipërmarrje agroturizmi të reja dhe 150 bujtina. Mbështetja do të synojë, gjithashtu, edhe përmirësimin e fermave dhe staneve blegtorale për qëllime të veprimtarisë së agroturizmit dhe turizmit rural.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton të ketë as plan veprimi e as monitorim të kryer mbi këtë shtesë të strategjisë e mbi situacionin e këtyre indikatorëve.

*Për të arritur zbatimin e SNZHRB, rezulton se:*

- *MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi mbi SNZHRB, që do të shërbente për të përcaktuar në mënyrë qartësisht të identifikueshme strukturat përgjegjëse, afatet, kostot, produktet dhe mënyrën e monitorimit të strategjisë, gjë e cila ka çënuar arritjen e objektivave finale të Strategjisë;*
- *Nisur nga shtrirja kohore e Strategjisë, si dhe nga dinamika dhe fokusi që ka patur në zhvillimin rural, sikurse bëhet fjalë në rastin e agroturizmit, MBZHR nuk ka kërkuar rinovime të Strategjisë, që reflektojnë fokusin e politikëbërjes në diversifikimin e aktiviteteve jobujqësore në zonat rurale, me objektiva konkrete e të matshme.*

*Referuar PIZHR, rezulton se:*

- *Nuk është hartuar plan veprimi vjetor, si dhe nuk ka patur monitorim të veprimtarisë mbi realizimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Integruar të Zhvillimit Rural;*
- *Në PIZHR nuk janë të ndara qartësisht detyrat ndërmjet aktorëve palë në zhvillimin e agroturizmit.*

## **Rekomandimet e KE mbi kapitullin 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural”**

Në Raportet e Komisionit European, përgjatë viteve 2018-2020, rekomandimet mbi kapitullin e Bujqësisë dhe zhvillimit rural, kanë qenë, si më poshtë:

### ➤ **Raporti i vitit 2018**<sup>5</sup>

Nuk ka sistem identifikimi të parcelave të tokës. Duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, përfshirë titujt e pronësisë dhe kthimin e tokave, autoritetet shqiptare duhet të marrin në konsideratë të fillojnë planifikimin e procesit sa më shpejt të jetë e mundur. Sistemi i integruar i administrimit dhe kontrollit ende nuk është implementuar plotësisht, por elemente të caktuara të tij, të tilla si një regjistër fermerësh dhe një regjistër kafshësh, janë zhvilluar. Nuk ka rrjet të të dhënave të kontabilitetit të fermave në vend dhe puna përgatitore për vendosjen e saj nuk ka filluar.

### ➤ **Raporti i vitit 2019**<sup>6</sup>

Nuk ka pasur progres në lidhje me ndërtimin e një Sistemi të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS). Duke pasur parasysh progresin e bërë në kthimin e tokës, autoritetet shqiptare duhet të fillojnë procesin sa më shpejt të jetë e mundur. Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit (IACS) ende nuk është implementuar plotësisht, por elemente të caktuara të tij - të tilla si një regjistër fermerësh dhe një regjistër kafshësh - janë zhvilluar. Nuk ka asnjë Rrjet të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (FADN) dhe puna përgatitore për ngritjen e tij nuk ka filluar. Autoritetet shqiptare duhet të fillojnë përgatitjet, p.sh. të miratojnë një plan zbatimi me një afat kohor konkret.

### ➤ **Raporti i vitit 2020**<sup>7</sup>

Duhet t'i jepet përparësi krijimit të një regjistri fermash deri në fund të vitit 2020. Ky është një element i sistemit të integruar të administrimit dhe kontrollit (IACS), por mund të jetë ndihmë për zbatimin e programit IPARD II. Shqipëria nuk regjistroi asnjë përparim në krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (LPIS) dhe nuk ka asnjë rrjet të dhënash të kontabilitetit të fermave (FADN). Sidoqoftë, ajo filloi punën themelore përgatitore për këtë të fundit dhe kjo duhet të shtohet duke miratuar një plan zbatimi me një afat kohor konkret.

Vërehet se, në raportet e 3 viteve të fundit 2018-2020 të KE, përmenden vazhdimisht krijimi i Regjistrimit të Fermave, krijimi i Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës, me qëllim zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit. Këto kanë qenë të përcaktuar edhe në SNZHRB si objektiva që prej vitit 2014

Për sa më sipër, nga ana e MBZHR rezulton se:

#### ➤ Gjendja aktuale e zbatimit të regjistrimit të fermave

Projekti i bashkëpunimit Italian po mbështet Agjencinë e Pagesave në forcimin e kapacitetit administrativ të MBZHR dhe Agjencisë së Pagesave, me një fokus të veçantë në regjistrin e fermave dhe LPIS, si një hap drejt vendosjes së sistemit IACS. Krijimi i një regjistri fermash është faza e parë e sistemit IACS. Lidhur me regjistrin e fermave, janë hedhur hapat, si më poshtë:

- Rihapja e Project Management Unit në MBZHR;
- Termat e referencës për krijimin e sistemit IACS janë hartuar dhe pritet të miratohen në Romë;
- Për të adresuar çështjet e ngritura nga DG Agri, të lidhura me fondet IPARD, është zhvilluar një program online për konsolidimin e të dhënave dhe regjistrimin e fermave në të gjitha rajonet e Shqipërisë;

<sup>5</sup> <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>6</sup> <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20190529-albania-report.pdf>

<sup>7</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf)

- Është miratuar Udhëzimi i Ministrit, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e regjistrimit të fermave;
- MBZHR ka hartuar një plan pune me të dhëna nga rajonet;
- Janë organizuar sesione trajnimit për stafin e Ministrisë, AZHBR, shërbimin Extension, Agropika, etj.

➤ Gjendja aktuale në lidhje me krijimin e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (FADN)

Në Janar 2020, një event i TAIEX (*Technical Assistance and Information Exchange instrument of the European Commission*) u organizua në Tiranë. Qëllimi ishte që të sigurohet mbështetja e MZHBR-së për përgatitjen e planit të implementimit për krijimin e FADN. Është kërkuar ndihmë nga fondet e BE-së ose donatorë të tjerë.

Në gusht të vitit 2020 u organizua një ëorkshop në internet me mbështetjen e Protokollit Italian për FADN. Bazuar në këtë seminar është përgatitur një projekt-propozim për veprimet në lidhje me harmonizimin e mjedisit ligjor për rishikimin e FADN (ligji, akti nënligjor/ strukturat që do të krijohen/ rolet e procedurave).

➤ Strategjia Kombëtare e Konsolidimit të Tokës (SKKT)

Është miratuar VKM Nr. 700, datë 12.10.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës Bujqësore në Shqipëri". Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i fermave familjare të suksesshme ekonomisht, konkurruese dhe të qëndrueshme që arrihet përmes krijimit të kushteve për konsolidimin e tokës bujqësore.

Kohëzgjatja e Strategjisë është planifikuar për një periudhë 15 vjeçare prej 2016 – 2030, e ndarë kjo në tre faza kryesore:

**Faza 1** (2016 - 2018): Punë përgatitore për programin e konsolidimit të tokës, kuadrin ligjor dhe projekte të tjerë pilot; Në fazën e parë do të ngrihej Sektori i Konsolidimit të Tokës (SKT) në MBZHR cili do përgatiste kuadrin ligjor dhe ndiqte të gjithë procedurat e përcaktuara në SKT. Ky sektor megjithëse është kërkuar shpesh herë ng ana e jone nuk është krijuar.

**Faza 2** (2019 – 2026): Zbatimi i projekteve të konsolidimit të tokës me theks në përmirësimin e strukturave të fermës;

**Faza 3** (2026 – 2030): Shtrirje e projekteve të konsolidimit të tokës në shërbim të iniciativave më të gjëra për zhvillim rural krahas përmirësimit të strukturave të fermës.

Faktorët kryesorë që kanë penguar zbatimin e strategjisë kanë qenë mungesa e një ligji për konsolidimin e tokës, kostot e larta të transaksionit, finalizimi i reformës së privatizimit të tokës, **plotësimi dhe regjistrimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore** në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Finalizimi dhe transferimi i pronësisë së tokës bujqësore dhe regjistrimi i titujve të pronësisë pranë Agjencive të Kadastrave Shtetërore, është parakusht për të siguruar arritjen e objektivit kryesor të Strategjisë së Konsolidimit të Tokës Bujqësore, sipas masave konkrete të përcaktuara në Programin Kombëtar për Konsolidimin e Tokës.

**Aktivitetet kryesore mbështetëse që kontribuojnë për konsolidimin e tokës janë:**

Krijimi i Sistemit të Informacionit të Tokës (LIS), nga zbatimi i Programit "Për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore". Ky program ka filluar që në vitin 2004, dhe implementohet nga QTTB Fushë Krujë dhe i referohet krijimit të sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe integritet në sistemin e informacionit gjeografik (GIS). Njëkohësisht, programi synon ndërtimin e infrastrukturës së GIS-it për grumbullimin, analizimin dhe azhurnimin e të dhënave për tokën si mjet kryesor në ndihmë të institucioneve shqiptare në formulimin, projektimin, për konsolidimin e tokës, në zbatimin dhe monitorimin e planeve të përdorimit të tokës në shkallë kombëtare, rajonale apo lokale. Mbi bazën e të dhënave të këtij programi fermerët mund të marrin rekomandime për përshtatshmërinë e tokës bujqësore. Ky proces ka ecur mirë duke siguruar informacione dixhitale që mbulojnë rreth 417,541 ha të

zonave bujqësore kryesisht intensive. Ky projekt financohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Nga Agjencia Kombëtare e Kadastrës, në total, regjistrimi fillestar i titujve të pronave, ka përfunduar në 2,747, zona kadastrale, nga 3,057 zona kadastrale gjithsej.

Gjithashtu ka përfunduar dhe miratimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) në 47, bashki të vendit nga 61 gjithsej. PPV sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, përmes përdorimit racional të tokës, me fokus ruajtjen e fondit të tokës bujqësore.

Prioritet po ju jepet rajoneve me bujqësi të zhvilluar dhe intensive, ku parcelat e vogla dhe të fragmentuara kufizojnë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë si një aktivitet parësor në zonat rurale, nëse ka interes nga fermerët. Ka një rritje të madhësisë së fermës nga 1.14 ha në 1.20 ha Ndërkohë që madhësia e parcelës ka mbetur e pandryshuar.

Është rritur sipërfaqja e tokës së mbjellë me 3,572 ha, si rezultat i qiradhënies së kësaj sipërfaqe nga MBZHR, konform legjislacionit, duke rritur numrin e të punësuarve dhe duke zhvilluar një bujqësi moderne.

MBZHR dhe aktorët e përfshirë në proces duhet të marrin masa të konsolidojnë Regjistrin e Fermës, Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës, duke bërë progres në këtë mënyrë në zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), si rekomandim i përvitshëm nga Komisioni Europian, por edhe si objektiva të Strategjisë Ndërkombëtare të Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, që do të ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit rural, por edhe zhvillimin bujqësor e rural në tërësi. Kujtojmë që, referuar Udhëzimeve të përvitshme për përfitimin nga Skemat Kombëtare, regjistrimi në regjistrin e fermës është kriter paraprak për çdo subjekt aplikues. Plotësimi i këtyre kriterëve do të akreditonte Shqipërinë edhe në masat e tjera të parashikuara nga Programi IPARD, duke bërë kështu që të thithen më shumë fonde për zhvillimin rural.

### ➤ **Veprimtaria e Agroturizmit**

Agroturizmi, si formë e veçantë e turizmit rural, është i orientuar drejt përdorimit të burimeve lokale të turizmit dhe ka si synim nxitjen e modeleve alternative të zhvillimit të produkteve turistike, nxitjen e prodhimit bujqësor/blegtoral, zhvillimin e zonave rurale si dhe krijimin e një tregu të ri për produktet bujqësore/blegtorale.

Sipas përcaktimit në VKM nr. 22, datë 12.1.2018<sup>8</sup>, agroturizmi duhet të ofrojë njëkohësisht zotërimin e një ferme bujqësore/blegtorale, shërbimin e akomodimit, të ushqimit dhe të aktiviteteve rekreative. Veprimtaria pritëse zhvillohet në fermat bujqësore/blegtorale, në të cilat ofrohen aktivite të lidhura me prodhimin bujqësor/blegtoral, por duke mos cenuar mjedisin. Përfshirja e vizitorëve në aktivitetet e lidhura me fermën duhet të jetë me qëllim argëtues, edukues apo veprimtari të tjera të lidhura me mjedisin përreth.

### **Kriteret për certifikimin e agroturizmit**

Agroturizmi, si veprimtari, duhet të zhvillohet minimalisht në një nga fermat e mëposhtme:

- a) Fermat bujqësore, të cilat kanë të paktën 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore;
- b) Ferma blegtorale, të cilat mbarështojnë, të paktën, 10 krerë gjedhë ose 100 krerë dele/dhi ose 200 krerë shpendë.
- c) Njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitet përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës.

---

<sup>8</sup> VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, Kapitulli II, “Kriteret dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë pritëse si “agroturizëm” dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të agroturizmit.”

Subjektet që zhvillojnë veprimtari pritëse të klasifikuara si “agroturizëm”, duhet të ofrojnë të njëkohësisht akomodim, ushqim dhe pije, si dhe veprimtari argëtuese/ çlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth. Objekti akomodues, në funksion të agroturizmit, duhet të ofrojë një kapacitet akomodimi nga 6 deri në 30 dhoma.

Ushqimi dhe pijet e ofruara në këto struktura duhet të jenë jo më pak se 30% të sasisë së tyre me origjinë nga ferma, jo më pak se 40 % të sasisë së tyre, me origjinë lokale, brenda territorit të bashkisë ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit dhe jo më shumë se 30% e sasisë së tyre me origjinë tjetër. Subjektet agroturistike ofrojnë/mundësojnë për vizitorët e turistët veprimtari argëtuese/ çlodhëse, që lidhen me fermën (si, p.sh., por pa u kufizuar, në mbjellje/vjelje të produkteve bujqësore, aktivitete të lidhura me kafshët, peshkim artizanal, degustim të produkteve etj.) ose jashtë fermës (si, p.sh., por pa u kufizuar, në hipizëm, alpinizëm, ecje në natyrë etj.).

Për certifikimin e subjekteve dhe dhënien, pezullimin ose shfuqizimin e “Certifikatës paraprake” ose “Certifikatës”, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ngrihet një komision vlerësues, i përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë përfaqësues të caktuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe 2 nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Certifikata paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm, e lëshuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, bazuar në vendimmarrjen e komisionit vlerësues, për subjektet e reja që kanë marrë miratimin paraprak të projekt-idesë nga komisioni. Kjo certifikatë lëshohet për të bërë të zbatueshëm legjislacionin në fuqi për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Me Urdhrin nr. 323, datë 18.09.2019, është ngritur Komisioni i vlerësimit për “Certifikatë për veprimtari pritëse e llojit agroturizëm” dhe “Certifikatë paraprake për veprimtari pritëse e llojit agroturizëm”. Komisioni mblidhet si rregull një herë në muaj, ose në çdo rast kur ka të paktën dy kërkesa për shqyrtim.

Deri në fillim të vitit 2021, janë certifikuar gjithsej 19 agroturizme dhe 8 subjekte janë pajisur me certifikatë paraprake.

Agroturizme te certifikuara		Certifikatë paraprake
1. Bujtina Roshnik	12. Mrizi i Zanave	1. Zavalani Farm sh.p.k.
2. Bujtina Tomadhe	13. Kodra e Kuajve	2. Kings Valley Farm sh.p.k.
3. Qafshatama sh.p.k	14. Gramozi BR	3. B-ST
4. Bujtina Dini	15. OurOën Expeditions	4. Esat Peci
5. Enol	16. Farma Sotira	5. Perla & Aura
6. Agro turizëm Huqi	17. Bujtina Xhufka	6. Blerti Mehillaaj
7. Kantina Nurellari	18. Bujtina Xhebro	7. Alehandro Distribuzione
8. Agro Gjepali	19. Kantina Arbri	8. Liliana Vllamasi
9. Agroturizëm Zerja		
10. Nari – Lundra		
11. Nano Bio Food		

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Foto 1, 2: Certifikata për veprimtari pritëse e llojit agroturizëm  
Burimi: Grupi i auditimit

Nëse marrim si shembull Italinë, shtet i cili është aktualisht lider në mënyrën se si ka ngritur dhe organizuar ekonominë rurale, lokale dhe kombëtare lidhur me agroturizmin, mund të vërejmë disa ndryshime thelbësore në këtë drejtim. Në shtetin fqinj, agroturizmi, si mënyrë për të promovuar bujqësinë nëpërmjet nxitjes së formave të ndryshme të turizmit në zonat rurale, është rregulluar me ligj<sup>9</sup>. Në vendin tonë kjo tematikë rregullohet nga VKM nr. 22, datë 12.01.2018, “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, i ndryshuar. Në konceptin e VKM-së së sipërcituar, agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës. Pra, në njëfarë mënyre, në vendin tonë kemi një lloj përmbysjeje të funksionit që duhet të ketë agroturizmi në ekonominë rurale, në kuptimin që nuk përmendet si thelbësor zhvillimi rural dhe bujqësor, duke u trajtuar kryesisht si një lloj turizmi.

Nga ana tjetër, nëse bëjmë një krahasim shumë të thjeshtë të dispozitave të VKM nr. 22 me ligjin e shtetit fqinj, vërejmë se, në këtë të fundit, disiplina e agroturizimit, si mënyrë për të promovuar bujqësinë rurale nëpërmjet nxitjes së formave të ndryshme të turizmit, rregullohet në të gjithë procesin vendimmarrës, duke përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes: pushtetin qendror dhe atë lokal, nisur edhe nga fakti se Italia është një shtet i decentralizuar, i ndarë në rajone.

Pra, ligji mbyll qarkun e përgjegjësive madhore mbi organizimin e agroturizmit në Itali duke parashikuar rezervën ligjore, për ato çështje të cilat duhen trajtuar më hollësisht nga rajonet përkatëse. Kjo gjë ndodh, jo vetëm për shkak të decentralizimit të Italisë në shtet rajonal, por edhe për arsye se rajone të ndryshme kanë produkte, tradita, përparësi dhe epërsi kulturele e bujqësore të ndryshme midis njëra tjetrës.

Konkretisht, parashikohet në këtë ligj kompetenca e rajoneve për të miratuar dhe publikuar listën e produkteve tipike e tradicionale të secilës prej tyre. Gjithashtu, me qëllim ruajtjen e lidhjes midis aktivitetit bujqësor dhe atij turistik, rajonet vendosin kriteret për ushtrimin e këtyre dy aktiviteteve, ku gjithmonë mbizotërues duhet të jetë aktiviteti bujqësor, pasi qëllimi kryesor i këtyre iniciativave është mbështetja e bujqësisë, si mënyrë për të promovuar forma të përshtatshme turizmit rural.

Një nga këto kriteret, ndoshta më interesante, është ai që i imponon sipërmarrësit bujqësor, i cili ofron përveç akomodimit, ushqimit e pijeve, të ofrojë një kuotë të caktuar të produkteve të veta, pa të cilën nuk do të kishte kuptim aktiviteti agroturistik. Pjesa tjetër e produkteve ushqimore e ofruar gjatë ushtrimit të aktivitetit duhet patjetër të ketë origjinë nga zona bujqësore kufitare apo të jetë prodhim i artizanëve agroushqimorë të zonës në të cilën ushtrohet aktiviteti. Gjithashtu, edhe aktivitetet rekreative dhe kulturore mund të zhvillohen vetëm nëse ato realizojnë maksimalisht lidhjen midis aktivitetit bujqësor me atë të ambientit kulturor, historik dhe mjedisor të zonës në të cilën ushtrohet aktiviteti agroturistik.

Në vendin tonë, VKM e sipërcituar disiplinon me saktësi kriteret që duhet të zbatohen sipërmarrësit bujqësor për të marrë certifikimin e ushtrimit të aktivitetit si sipërmarrje agroturistike, por pa vendosur theksin si fillim në fuqizimin e ekonomisë bujqësore, si një veçanti rajonale ose krahinore e zonave të ndryshme të vendit tonë, ndoshta edhe duke edukuar fermerin për rëndësinë e produkteve tipike dhe vendosur theksin në epërsinë e bukurive natyrore dhe pasurive agroushqimore të vendit tonë. Vërehet në këtë bazë ligjore një përfshirje e vakët e pushtetit vendor në vendimmarrje dhe në përcaktimin e kriterëve thelbësore lokale që duhen plotësuar për të qenë vërtet sipërmarrës bujqësor, i cili mund të konsiderohet rojtar i kulturës, vlerave dhe pasurive bujqësore dhe agroushqimore. Një bazë ligjore sikundër kjo që ne kemi aktualisht, nuk i jep dinjitetin që meriton aktivitetit bujqësor në vendin tonë.

---

<sup>9</sup> Legge 20 febbraio 2006, nr. 96 “Disciplina dell’agriturismo”.

### **Gjetje nr. 1:**

Nga auditimi u konstatua se:

1. Ministra e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka përcaktuar objektiva për zhvillimin e agroturizmit në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor;
2. MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, që do të shërbente për të përcaktuar në mënyrë qartësisht të identifikueshme strukturat përgjegjëse, afatet, kostot, produktet dhe mënyrën e monitorimit të strategjisë, gjë e cila ka çënuar arritjen e objektivave finale të Strategjisë;
3. Nisur nga shtrirja kohore e Strategjisë, si dhe nga dinamika dhe fokusi që ka patur në zhvillimin rural, sikurse bëhet fjalë në rastin e agroturizmit, MBZHR nuk ka bërë përditësime të Strategjisë, për të reflektuar fokusin e politikëbërjes në diversifikimin e aktiviteteve jobujqësore në zonat rurale, me objektiva konkrete e të matshme.
4. MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi vjetor për Programin e Integruar të Zhvillimit Rural, si dhe nuk ka patur monitorim të veprimtarisë mbi realizimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Integruar për Zhvillim Rural;
5. Në PIZHR nuk janë të ndara qartësisht detyrat ndërmjet aktorëve palë në zhvillimin e agroturizmit.

### **Konkluzion:**

Referuar faktit që agroturizmi është një sektor në fillimet e tij, nisur nga veçoritë e specifikat që e karakterizojnë, si dhe nga potenciali i lartë që ka për zhvillim, fokusi i dhënë ndaj tij në dokumentet politikë nuk është i mjaftueshëm. Në asnjë nga dokumentet e sipërpërmendura nuk janë të ndara qartazi detyrat dhe përgjegjësitë institucionale për zhvillimin e agroturizmit, çka mund të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori. Për të garantuar një zhvillim të qendrueshëm të turizmit rural dhe agroturizmit, në këtë fazë fillestare që ky sektor është, është e nevojshme të hartohet një strategji e veçantë që do të rregullonte të gjithë këtë sektor, me qëllim për të shfrytëzuar potencialin e madh që gjendet në diversifikimin e ekonomisë jobujqësore në zonat rurale. Qëndrueshmëria e turizmit në zonat rurale do të jetë e suksesshme vetëm nëse një strategji gjithëpërfshirëse miratohet dhe zbatohet, bazuar në një qasje pjesëmarrëse me shumë aktorë.

### **Rekomandim nr. 1:**

MBZHR të hartojë një strategji SMART<sup>10</sup> që të konsistojë në zhvillimin e turizmit rural, agroturizmit e bujtinave. Strategjia duhet të synojë të mbështesë e të orientojë diversifikimin e aktiviteteve jobujqësore në zonat rurale, me qëllim që të krijohen mekanizma nxitës që, zonat rurale të mos jenë ekskluzivisht bujqësore, por të nxiten edhe forma të tjera zhvillimi. Me qëllim arritjen e objektivave, strategjia duhet të ketë të mirëpërcaktuar:

- Ndarjen e qartë të detyrave midis palëve të përfshira (aktive e pasive) në zhvillimin e agroturizmit (duke nisur që nga politikat mbështetëse, monitorimet, infrastruktura, burimet njerëzore, e deri te mbledhja e të dhënave e statistikave të vazhdueshme, që do të ndihmonin në politikëbërje të qendrueshme;
- Përcaktim të objektivave të matshme;
- Komunikim të vazhdueshëm midis palëve, duke krijuar një zinxhir funksional, që do të garantonte bashkëpunim të mirëfilltë, me qëllim arritjen e objektivave;
- Planet e veprimit me detyra konkrete për secilën nga palët e përfshira;
- Monitorim të vazhdueshëm të objektivave, me qëllim evidentimin në kohë të risqeve që mund të çojnë në mospërmbushjen e këtyre objektivave.

**Brenda vitit 2022**

---

<sup>10</sup> Specific, Measurable, Achievable, Realistic, and Timely

**Gjetje nr. 2:**

MBZHR nuk ka hartuar një ligj specifik për agroturizmin, i cili do të nxisë zhvillimin e këtij sektori, duke vlerësuar potencialin që ky aktivitet ka.

**Konkluzion:**

Duke qenë se sektori i agroturizmit është një sektor në hapat e parë të zhvillimit, ka nevojë për një bazë ligjore referuese, qoftë për institucionet të cilët do të udhëheqin e mbikëqyrin zhvillimin e këtij sektori, ashtu edhe për subjektet private që do të konsiderojnë të përfshihen në këtë sektor, duke ndarë qartazi rolet, përgjegjësitë e detyrat mes aktorëve të përfshirë.

**Rekomandim nr. 2:**

MBZHR, referuar praktikave të mira të vendeve model suksesi në fushën e agroturizmit, të marrë masa për hartimin dhe paraqitjen për miratim të një Ligji specifik për agroturizmin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qendrueshëm të këtij sektori, duke ndarë dhe detyrat e përgjegjësitë midis palëve, duke përfshirë pushtetin qendror e atë lokal. Ligji duhet të përcaktojë qartazi detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të pushtetit qendror e lokal, si dhe mundësitë për subjektet private që do të konsiderojnë agroturizmin si mënyrë për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor dhe turistik.

*Qershor 2022*

**Gjetje nr. 3:**

MBZHR nuk ka konsoliduar ende Regjistrin e Fermës, Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës, sipas objektivave të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, kapitulli 3 “*Politikat kryesore për zhvillimin bujqësor dhe rural*”, konkretisht pika 3.3.1 “*Kushtet kuadër për zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit bujqësor*”.

**Konkluzion:**

Një nga problematikat që pengojnë zhvillimin e agroturizmit, por edhe zhvillimin rural në tërësi, janë mungesa e Regjistrit të Fermës, Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës. Të treja të mësipërmet janë faktorë kyç në zhvillimin rural, duke qenë se pa konsoliduar regjistrin e fermës dhe pa patur një tablo të përgjithshme të sistemit të identifikimit të parcelave të tokës, çdo politikë mbi zhvillimin rural do të ishte e cunguar. Këto kanë qenë objektiva të përcaktuara në SNZHRB që prej vitit 2014 dhe, edhe pse SNZHRB përfundonte shtrirjen e saj në vitin 2020, asnjë nga tre të mësipërmet nuk ka përfunduar. Këto problematika janë parashtruar edhe në Progres Raportet e KE përgjatë 3 viteve të fundit dhe zgjidhja e tyre do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), duke ndihmuar politikat e zhvillimit të turizmit rural, duke u akredituar edhe në masa të tjera të programit IPARD e duke krijuar mundësi për të përthithur më shumë fonde nga ai program dhe, më gjërë, duke bërë hapa përpara drejt integritimit në BE.

**Rekomandim nr. 3:**

MBZHR të marrë masa që, së bashku me aktorët e përfshirë në proces, të evidentojë problematikat që kanë sjellë mosrealizimin e këtyre objektivave, si dhe të hartojë politika me qëllim konsolidimin e Regjistrit të Fermës, Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës, duke bërë progres në këtë mënyrë në zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

*Brenda vitit 2021*

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit, mbi rekomandimet e mësipërme, nga subjekti i audituar MBZHR është paraqitur observacioni me nr. 204/6 prot., datë 19.08.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:  
Pretendimi i subjektit:**

*“1. Gjetja nr. 1, mungesa e një baze ligjore specifike për agroturizmin, si dhe ndarja e funksioneve dhe përgjegjësisë është e saktë dhe qendron. Lidhur me rekomandimin nr. 1, për hartimin e një strategji SMART për agroturizmin, përcaktimin e objektivave të matshëm, komunikimin mes palëve, planet e veprimit, si dhe monitorimin, bëj me dije se jemi në fazën e hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027, ku pjesë është dhe sektori i agroturizmit, për të cilin janë përcaktuar nevojat dhe do të adresohen përmes masave përkatëse.*

*2. Gjetja nr. 2, mungesa e një ligji specifik për agroturizmin, si dhe rekomandimi për hartimin e tij, bazuar në praktikën e mira, lidhet me fushën e përgjegjësisë së MBZHR. Referuar dhe pikës 1, strategjia e re do të shtjellojë sipas masave përkatëse, të gjitha çështjet lidhur me këtë pikë, bazuar në praktikën më të mira të vendit tonë.*

*3. Lidhur me rekomandimin nr. 3, për moskonsolidimin e Regjistrit të Fermës dhe FADN-së, sipas objektivave të përcaktuara në strategji, bëjmë me dije se ka filluar puna për Regjistrin e Fermës, për të cilin janë rishikuar Urdhëri dhe Udhëzimi përkatës i Ministrisë.”*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Ajo çfarë subjekti citon në observacionin nr. 204/6 prot., datë 19.08.2021, ngjason më shumë me një plan masash që subjekti do të marrë për zbatimin e rekomandimeve të lëna, me qëllim përmirësimin e performancës në sektorin e agroturizmit dhe nuk shpreh kundërshti me gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit, mbi përmirësimin dhe përfundimin e bazës ligjore për zhvillimin e agroturizmit.*

#### **4.1.2 A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/arritjen e objektivave?**

Agroturizmi është një lloj hibrid i sistemit bujqësor që bashkon elementët e bujqësisë dhe turizmit për të krijuar ofertë për produktet dhe shërbimet bujqësore si dhe për të ofruar eksperiencën për turistët.

Konceptet e turizmit rural dhe agroturizmit shpeshherë ngatërrohen nga fermat dhe agrobizneset, madje ndonjëherë edhe në nivel institucional, veçanërisht tani që agroturizmi po trajtohet si sektor i veçantë dhe aktiviteti biznesi fitimprurës.

Agroturizmi është një aktiviteti pritës që zhvillohet në fermë ose në njësi të tjera bujqësore me qëllim tërheqjen e vizitorëve, shpesh duke u mundësuar që të marrin pjesë në aktivitete bujqësore ose aktivitete të tjera ndihmëse që zhvillohen në mjedisin bujqësor<sup>11</sup>.

Çdo formë e turizmit që tregon jetën rurale, artin, kulturën dhe trashëgiminë në vendet rurale, që i sjell komunitetit vendas përfitime ekonomike dhe sociale, si dhe që mundëson ndërveprimin midis turistëve dhe banorëve vendas për një përvojë më të pasur turistike, mund të përkufizohet si turizëm rural<sup>12</sup>.



Foto 3, 4: Aktivitete në subjekte të certifikuar si “agroturizëm” në Shqipëri  
Burimi: Grupi i auditimit

<sup>11</sup> VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”, i ndryshuar

<sup>12</sup> OECD

Për ta përmbledhur, agroturizmi është një nëndegë e turizmit rural, me një koncept më të gjerë që mund të përfshijë pothuajse çdo veprimtari turistike që zhvillohet në vendet rurale.



Foto 5, 6: Aktivitete në subjekte të certifikuar si “agroturizëm” në Shqipëri

Megjithëse ka disa sinonime të përdorura për të përshkruar përfshirjen e aktiviteteve turistike në aktivitetet e fermave, të gjitha këto përkufizime i përshkruajnë aktivitetet e turizmit si një shtesë, ndërsa aktivitetet bujqësore mbeten fokusi kryesor për sa i përket angazhimit në kohë. Përveç kësaj, n.q.s i referohemi rastit më të njohur të zhvillimit të agroturizmit, rajonit të Toskanës, Itali, legjislacioni rajonal në fuqi e përcakton agroturizmin si: “ferma që sigurojnë akomodim; organizon veprimtari arsimore, informuese, kulturore, sociale, tradicionale; ofron ushqime dhe pije, prodhon dhe ofron produkte vendore si dhe produkte të çertifikuara me origjinë toskane”<sup>13</sup>.

Duke iu referuar Ligjit rajonal për Agroturizmin në rajonin e Italisë, neni 5, citohet: “*Funksionimi i agroturizmit është i rezervuar për sipërmarrësit bujqësorë ...*”. Në Ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, neni 4, Agroturizmi përkufizohet si: “*veprimtaria pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtaritë e tjera ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor*”<sup>14</sup>. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

Një nga vështirësitë e deritanishme, është mungesa e infrastrukturës rrugore që lidh zonat rurale me ato urbane, por edhe lidhja e prodhimit me tregun. Duke qenë se Agroturizmi është i përqëndruar në zonat rurale, zhvillimi i tij është i lidhur ngushtë me zhvillimin e infrastrukturës rrugore. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të rrisë aksesin drejt zonave rurale e turistike duke shkurtuar kohën si dhe rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve.



Foto 7: Infrastruktura rrugore në drejtim të një Agroturizmi  
Burimi: Grupi i Auditimit

<sup>13</sup> Legge Regionale no. 80 del 28.12.2009 “Disciplina delle attività agrituristiche in Toscana” (B.U.R. Toscana n. 56 del 31.12.2009)

<sup>14</sup> Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”

Agroturizmi po promovohet si një mënyrë për të gjeneruar të ardhura shtesë për fermat dhe ka shumë mënyra për të gjeneruar shitje. Shtimi i shërbimeve turistike do të shërbente si strategji diversifikuese për fermat, duke kontribuar në prurje më të qëndrueshme të të ardhurave, duke përfshirë tarifa për akomodimin, tarifa ushqimin dhe degustimin, shitjen e produkteve të ndryshme në fermë, etj.



Foto 8, 9, 10: Aktivitete në subjekte të certifikuar si “agroturizëm” në Shqipëri  
Burimi: Grupi i auditimit

Zhvillimi i agroturizmit në Shqipëri po përjeton një rritje të konsiderueshme. Që nga viti 2018, 19 subjekte janë certifikuar si të tillë dhe 8 subjekte të tjerë kanë marrë certifikatën paraprake. Zhvillimi i agroturizmit luan një rol të rëndësishëm në diversifikimin e aktiviteteve të fermave dhe, si rrjedhojë, nxitet zhvillimi rural. Ky fenomen i ri në Shqipëri po nxit kontaktin e banorëve urbanë drejt zonave rurale. Ky aktivitet konsiderohet si një mundësi e mirë për fermerët për t’u fuqizuar ekonomikisht. Sidoqoftë, brenda MBZHR nuk ka një njësi të dedikuar për zhvillimin e agroturizmit, në mënyrë që, njësitë e agroturizmit të kenë një strukturë ku mund të adresohen për çdo sfidë apo problematikë që mund të hasin gjatë ngritjes dhe zhvillimit të agroturizmit.

Aktorët kryesorë të përfshirë në menaxhimin e sektorit të agroturizmit, dhe rolet që ato kanë, paraqiten në tabelën, si më poshtë:

Palët e përfshira (aktive/inaktive) në rang kombëtar	Roli
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është e përfshirë drejtpërdrejt në zhvillimin e agroturizmit. MBZHR është e përfshirë drejtpërdrejt në sigurimin e mbështetjes financiare përmes skemave Kombëtare dhe programit IPARD II (2014-2020). Për më tepër, kjo Ministri koordinon përfshirjen e donatorëve të tjerë të huaj/ ndërkombëtarë, si GIZ, FAO dhe USAID. MBZHR përfaqësohet

	në komisionin ndërministror e certifikimit të fermave agroturistike.
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është autoriteti kompetent me funksione inspektimi për menaxhim në nivelin kombëtar të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve. AKU udhëheq procesin e vlerësimit të rrezikut në fushën e ushqimit të kafshëve, ushqimit dhe mbrojtjes së bimëve. Planifikon, koordinon dhe ushtron kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshët dhe mbrojtjen e bimëve. Siguron unifikimin e sigurisë ushqimore dhe praktikave të kontrollit të ushqimit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve në të gjithë vendin. Kryen inspektime paraprake për të verifikuar nëse janë përmbushur kërkesat tekniko-teknologjike, higjeno-sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor dhe mbrojtjen e bimëve.
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Kjo ministri është e përfshirë drejtpërdrejt në zhvillimin e agroturizmit. Kjo Ministri ka shumicën në komisionin ndërministror që certifikon fermat e agroturizmit. Për më tepër, ndërsa koncepti i agroturizmit përmendet në Ligjin e Turizmit, nuk ka ndonjë kompetencë të veçantë që i është dhënë kësaj Ministrie në lidhje me zhvillimin e agroturizmit.
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	AKPT është e lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e agroturizmit, si njësi përgjegjëse për zbatimin e programit IPRD “100 fshatrat”, ku agroturizmi është një nga shtyllat e tij të rëndësishme. Sidoqoftë, kohët e fundit kjo agjenci nuk ka qenë aktive në lidhje me ndonjë iniciativë për zhvillimin e agroturizmit.
Instituti i Statistikave (INSTAT)	INSTAT është indirekt i lidhur me zhvillimin e agroturizmit. Ky institut mund të jetë një “stakeholder” me një rol të rëndësishëm, përmes sigurimit të të dhënave dhe informacionit, siç janë trendet e vizitorëve për agroturizëm etj. Megjithatë, ky institut nuk ofron ndonjë të dhënë dhe informacion në lidhje me turizmin rural, dhe për më tepër, në lidhje me agroturizmin. Të dhënat e siguruar nga ky institut kanë të bëjnë vetëm me turizmin në përgjithësi, numrin e njësive akomoduese dhe destinacione të tjera turistike, etj.
Akademia	Akademia indirekt është e lidhur me zhvillimin e agroturizmit. Në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ekziston një departament me emrin Menaxhimi i Turizmit Rural, i cili ka një planprogram me një fokus specifik në turizmin rural dhe zhvillimin e agroturizmit. Ky departament ofron program studimesh në nivelin Bachelor dhe Master. Çdo vit numri i studentëve të diplomuar janë afërsisht 70-80 në nivelin Bachelor, dhe 15-20 për nivelin Master. Ky profil i turizmit ofrohet vetëm nga ky universitet. Përgjatë periudhës 2016-2019, numri i studentëve të regjistruar, në këtë program studimi, u rrit nga 67 në 90. Në Universitetin e Tiranës ekziston një program studimi mbi turizmin në përgjithësi, por nuk përqendrohet në turizmin rural. Ky program studimi ofrohet në nivelet Bachelor dhe Master. Në Universitetin e “Aleksander Moisiu” ekziston edhe një program studimi mbi Menaxhimin e Hoteleri-Turizmit. Ka edhe disa Universitete të tjera private që ofrojnë këto programe studimi.
Donatorët dhe OJQ-të	Këta “stakeholders” janë të lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e agroturizmit dhe aktualisht janë aktivë. Kohët e fundit disa donatorë të huaj janë të angazhuar drejtpërdrejt në zhvillimin e agroturizmit. Disa nga këta donatorë ndërkombëtarë janë FAO, USAID dhe GIZ. USAID ka mbështetur financiarisht projektin në Belsh, në fshatin Seferan, ku u krijua një strukturë agroturizmi si një rrjet midis një restoranti, afër liqenit, një shtëpie për mysafirë dhe fermerëve vendas. GIZ aktualisht po synon të ndërmarrë një studim kombëtar në lidhje me situatën aktuale të zhvillimit të agroturizmit dhe ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen.
Klientët/ tregu i turistëve	Këta “stakeholders” janë të lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e agroturizmit. Klientët luajnë rolin thelbësor në nxitjen e zhvillimit të agroturizmit. Ekziston një kërkesë në rritje për të vizituar hapësirat rurale, për të ngrënë produkte me origjinë, për t'u përfshirë në aktivitete bujqësore, etj. Në këtë drejtim, kjo kërkesë në rritje për komoditete bujqësore, i ka nxitur fermerët të hapin fermën e tyre ndaj vizitorëve. Duke iu referuar studimit të <i>Domí et al. (2019)</i> , të gjitha fermat e agroturizmit në Shqipëri kishin një numër mesatar në javë prej afërsisht 400-600 vizitorësh, kryesisht gjatë sezonit të pranverës e në fundjavë. Duke marrë parasysh kategoritë e vizitorëve që vizituan fermat e agroturizmit, përgjatë vitit 2018, janë qytetarë shqiptarë, vizitorë nga Evropa dhe familje me fëmijë të vegjël. Për më tepër, grupe të tjera, si të rinjtë, pensionistët, grupet

	shkollore dhe grupet e tjera të organizuara, janë gjithashtu të rëndësishme, por më pak të shpeshta.
<b>Palët e interesit në nivel lokal</b>	
Organet e qeverisjes lokale	Organet e qeverisjes lokale janë të lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e agroturizmit. Neni 19 i ligjit të Turizmit, thekson rolin e qeverive lokale "për të kontribuar në zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në nivelin lokal, të tilla si turizmi kulturor, agroturizmi etj., bazuar në burimet e turizmit". Në disa raste qeveritë lokale (bashkitë) ndikojnë drejtpërdrejt dhe indirekt në rrjedhën e turizmit në ndërmarrjet lokale, përmes organizimit të organizimeve e eventeve, të tilla si karnavalet, panairët e produkteve lokale, festivalet, etj. Këto ngjarje mund të tërheqin vizitorë në fermat e agroturizmit. Përveç kësaj, përmes restaurimit dhe mirëmbajtjes së vendeve kulturore, monumenteve natyrore, peizazheve fotografike dhe tërheqjeve të tjera të turizmit lokal, qeveritë lokale mund të ndikojnë në numrin e rrjedhës së turizmit në zonë.
Agjencitë turistike	Agjencitë turistike janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e agroturizmit. Agjencitë e turizmit luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e vizitave të turistëve dhe kryesisht, në nivelin ndërkombëtar, për agroturizmin. Sidoqoftë, gjatë diskutimit me operatorët e agroturizmit, fermerët, pronarë të bujtinave, ata thanë se agjencitë e turizmit janë ato që diktojnë bashkëpunimin e tyre, duke ndikuar në llojin e shërbimeve të ofruara për turistët, në mënyrë që të rritet marzhi i fitimit lloji i shërbimit të ofruar, është një dimension negativ në këtë bashkëpunim, sepse kjo mund të dëmtojë imazhin e agroturizmit ndaj vizitorëve, dhe më vonë ata mund të mos e përsërisin vizitën e tyre.
Fermerët	Fermerët janë të përfshirë drejtpërdrejt në zhvillimin e agroturizmit, dhe aktualisht janë aktivë. Ata janë aktorët më të rëndësishëm në lidhje me agroturizmin për shkak se fermerët janë furnizuesit kryesorë të fermave të agroturizmit dhe restoranteve të tyre, me produkte vendase (produkte origjinë). Kanalet kryesore tregtare të produkteve të origjinës janë tregjet ndërkombëtare dhe shitja e drejtpërdrejtë përmes fermave të agroturizmit. Produktet vendase përbëjnë një tërheqje të rëndësishme për vizitorët në fermë. Ndonjëherë, fermerët ofrojnë produkte vendore dhe varietete të bimëve lokale në tregjet lokale dhe restorantet. Në të vërtetë, nuk ka politikë për të theksuar qëndrueshmërinë e këtyre produkteve. Varietetet lokale ose racat lokale menaxhohen dhe riprodhohen kryesisht nga fermerët, pa ndonjë bashkëpunim me bankën Genetic dhe institutet kërkimore për të garantuar mbrojtjen e këtyre varieteteve.
Shërbime të vogla agroturistike	Shërbimet e vogla agroturistike (restorante, B&B) janë palë të interesuara lokale shumë të rëndësishme në zhvillimin e agroturizmit. Këto lloje shërbimesh janë një degë e rëndësishme e veprimtarive agroturistike. Disa biznese agroturiste përdorin bimë lokale, perime dhe varietete frutash të cilat rriten në natyrë, praktikë e cila mund të rrezikojë këto specie dhe varietete dhe të zvogëlojë biodiversitetin dhe agrobiodiversitetin. Rritja dhe zhvillimi i bizneseve të tilla në zonat rurale mund të sjellë rrezikun e rritjes së ndotjes, për sa kohë që në këto zona menaxhimi i mbetjeve të prodhuara gjatë aktivitetit të tyre nuk është zgjidhur ende plotësisht.

*Tabela nr. 1. Palët e përfshira në zhvillimin e agroturizmit  
Burimi: Agritourism development in Albania, FAO*

## **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është e përfshirë drejtpërdrejt në zhvillimin e agroturizmit. MBZHR është e përfshirë në sigurimin e mbështetjes financiare përmes skemave Kombëtare dhe programit IPARD II (2014-2020). Për më tepër, kjo Ministri koordinon përfshirjen e donatorëve të tjerë të huaj/ ndërkombëtarë, si GIZ, FAO dhe USAID. MBZHR përfaqësohet në komisionin ndërministror të certifikimit të fermave agroturistike.

Nga ana tjetër, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural funksionon si Agjenci e Pagesave, duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe duke zbatuar

politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë. AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural dhe ka për detyrë:

- Të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural;
- Të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- Të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- Të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- Të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
- Të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.

### **MBZHR – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**

VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij” përcakton se për certifikimin e subjekteve dhe dhënien, pezullimin ose shfuqizimin e “Certifikatës paraprake” ose “Certifikatës”, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin ngrihet një komision vlerësues, i përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë përfaqësues të caktuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe 2 nga ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Në konceptin e VKM-së së sipërcituar, agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës. Pra, në njëfarë mënyre, në vendin tonë kemi një lloj përmbysjeje të funksionit që duhet të ketë agroturizmi në ekonominë rurale, në kuptimin që nuk përmendet si thelbësor zhvillimi rural dhe bujqësor, duke u trajtuar kryesisht si një lloj turizmi, ndërkohë që në përkufizimet e njohura të agroturizmit, ai trajtohet si mënyrë për të promovuar bujqësinë rurale nëpërmjet nxitjes së formave të ndryshme të turizmit.

### **Aktorë të tjerë**

Disa nga problematikat e tjera të hasura gjatë auditimit, që konsistojnë në ndarjen e roleve dhe të përgjegjësive të aktorëve në zhvillimin e sektorit të agroturizmit paraqiten, si më poshtë:

➤ Nga vizitat në terren dhe intervistat me sipërmarrës të bizneseve në sektorin e agroturizmit, vështirësitë më të mëdha janë konstatuar në **infrastrukturë**. Duke qenë se këto lloje investimesh janë kryesisht në zona rurale, infrastruktura rrugore ishte mjaft e dobët. Problematika të tjera lidhur me infrastrukturën konsistonin në furnizimin me energji elektrike dhe ujë. Investimet në sektorin e agroturizmit janë të pamjaftueshme, në rast se ato vijnë të shkëputura nga investimet në infrastrukturë. Për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm në sektorin e agroturizmit, është i nevojshëm bashkëpunimi edhe me institucionet përgjegjëse për krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin rural.

➤ Një tjetër problematikë e konstatuar ishte mungesa e **burimeve të kualifikuara njerëzore**. Veç të tjerash, duke konsideruar që shumë prej këtyre bizneseve operonin me turistë të huaj, nisur nga zonat rurale në të cilat këto biznese operonin, sipërmarrësit shpreheshin se ishte e vështirë të gjeje staf të kualifikuar dhe me njohuri të gjuhëve të huaja. Mund të konsiderohet bashkëpunimi i mëtejshëm me shkollat profesionale, me qëllim krijimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të ndihmuar në zhvillimin e sektorit të agroturizmit dhe turizmit rural.

➤ Një problematikë tjetër e hasur nëpërmjet intervistave të kryera në subjekte gjatë auditimit ishte **mungesa e statistikave dhe të dhënave zyrtare** në fushën e agroturizmit. Mungesa e statistikave dhe të dhënave të sakta mbi fushën e agroturizmit mund të krijojë probleme edhe në hartimin e politikave dhe është e nevojshme që MBZHR, AZHBR dhe institucionet e tjera

përgjegjëse të bashkëpunojnë për krijimin e një databazë me statistika e të dhëna zyrtare të lidhura me turizmin rural dhe agroturizmin.

**Gjetje nr. 4:**

MBZHR nuk ka ngritur një strukturë të veçantë të dedikuar për agroturizmin, duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimit të këtij sektori, që do të ndihmonte në hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikave, si dhe në të cilën do të adresohet çdo problematikë e hasur, nga secili prej aktorëve të përfshirë, përgjatë rritjes së këtij aktiviteti.

**Konkluzion:**

Zhvillimi i agroturizmit në Shqipëri po përjeton një rritje të konsiderueshme. Që nga viti 2018, 19 subjekte janë certifikuar si të tillë dhe 8 subjekte të tjerë kanë marrë certifikatën paraprake. Zhvillimi i agroturizmit luan një rol të rëndësishëm në diversifikimin e aktiviteteve të fermave dhe, si rrjedhojë, nxitet zhvillimin rural. Ky fenomen i ri në Shqipëri po nxit kontaktin e banorëve urbanë drejt zonave rurale. Ky aktivitet konsiderohet si një mundësi e mirë për fermerët për t'u fuqizuar ekonomikisht. Aktualisht nuk ekziston një strukturë e dedikuar për zhvillimin e agroturizmit, në mënyrë që, në të cilën njësitë e agroturizmit mund të adresohen për çdo sfidë apo problematikë që mund të hasin gjatë ngritjes dhe zhvillimit të agroturizmit.

**Rekomandim nr. 4:**

MBZHR, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit të agroturizmit, të angazhohet për krijimin e një sektori të dedikuar për agroturizmin.

*Janar 2022*

**Gjetje nr. 5:**

Nga intervistat e kryera në subjekte gjatë fazës së terrenit, ka rezultuar se MBZHR dhe AZHBR nuk administrojnë të dhëna specifike për sektorin e agroturizmit, si psh numri i të punësuarve në atë sektor, numri i turistëve që kanë frekuentuar atë sektor, ndikimin që ai sektor ka në ekonomi, e çdo të dhënë e statistikë tjetër që mund të lidhet direkt e indirekt me sektorin e agroturizmit.

**Konkluzion:**

Mungesa e të dhënave specifike e të përditësuara mbi agroturizmin çënon mundësinë e përcaktimit të politikave eficiente për zhvillimin e sektorit.

**Rekomandim nr. 5:**

MBZHR, në bashkëpunim me AZHBR dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të krijojë një databazë të detajuar me të dhëna specifike e të përditësuara për agroturizmin.

*Brenda vitit 2021*

## **4.2 A ka arritur rezultatet e synuara dinamika e zhvillimit të agroturizmit?**

### **4.2.1 A është garantuar plotësimi i nevojave/kërkesave për zhvillimin e agroturizmit?**

Zhvillimi i agroturizmit është pjesë e Programit Qeverisës 2017-2021. "Rilindja rurale" do të jetë programi i integruar i zhvillimit të qendrave të banuara, zonave me interes turistik, apo i zonave rurale në të cilat do të synohet përmirësimi infrastrukturës, vlerësimi i traditave dhe trashëgimisë kulturore, rritja e nivelit të shërbimeve publike, përmirësimi estetik i qendrave të banuara që i jep mundësi zonave të caktuara rurale të kenë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm, duke krijuar njëherazi edhe premisat për zhvillimin e turizmit dhe agroturizmit.

Në SNZHRB 2014-2020, përcaktohet se agroturizmi do të jetë një ndër mjetet jo vetëm të promovimit turistik, zhvillimit ekonomik por edhe të rritjes së qëndrueshmërisë së turizmit dhe ruajtjes dhe promovimit të identitetit kulturor edhe rural. Gjithashtu SNZHRB e konsideron agroturizmin si një sektor potencial për diversifikimin e të ardhurave dhe krijimin e mundësive të punësimit në zonat rurale.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 përqendrohet në rëndësinë e diversifikimit të ofertës aktuale të turizmit, në mënyrë që të sigurohet zhvillim i integruar i turizmit. Turizmi rural dhe agroturizmi konsiderohen sektorë potencialë që sigurojnë diversifikimin e turizmit dhe zgjerojnë sezonin turistik.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (SKZHQT) 2018-2022, agroturizmi konsiderohet jo vetëm një sektor që mund të ndihmojë promovimin turistik dhe zhvillimin ekonomik, por edhe si një sektor që do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar.

Parë nga kjo perspektivë sinergjite midis institucioneve publike dhe projekteve të donatorëve me fokus agroturizmin janë të rëndësishme në krijimin e efekteve më të mëdha të integruara, të cilat do të sillnin një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

Sektori i agroturizmit po përfiton nga disa stimuj fiskalë që përfshijnë reduktim të tvsh-së në 6%, tatim mbi të ardhurat e shoqërisë në 5% dhe përjashtim nga taksa e infrastrukturës për investimet. Stimulimi i investimeve nëpërmjet këtyre politikave duhet të nxisë interesin e njësive të agroturizmit dhe të zgjerojë bazën e tyre. Nëpërmjet skemave kombëtare të mbështetjes duket sikur ka një fokus për nxitjen e ofertës ndërkohë që nuk duket të ketë një kombinim për të krijuar edhe kërkesë njëkohësisht.

Për, sektorin e agroturizmit, megjithëse pjesë e Programit të Qeverisë dhe Strategjive Kombëtare, nuk ka ende një strategji të dedikuar dhe një plan veprimi me indikatorë të matshëm dhe role të mirëpërcaktuara. Mungesa e politikave nxitëse dhe integrimi i tyre me politikat e zhvillimit rural në tërësi përbëjnë një faktor me risk për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

MBZHR nuk ka në strukturën e saj asnjë sektor që i kushtohet agroturizmit dhe nuk disponon asnjë të dhënë statistikore që lidhet me zhvillimin ose gjendjen aktuale të investimeve të kryera.

Nga të dhënat e grumbulluara gjatë fazës së terrenit nuk rezultojnë raporte koordinimi ose bashkëpunimi mes MBZHR dhe MTM që lidhen me zhvillimin e sektorit të agroturizmit.

Gjithashtu, nuk ka evidencë të raportimeve periodike nga AZHBR për MZHBR që lidhen me sektorin e agroturizmit.

Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit intervistoi disa nga subjektet përfituese të fondit për zhvillimin e agroturizmit. Problematikat kryesore të shfaqura lidheshin me infrastrukturën jo të mirë rrugore, rrjetin elektrik shpesh herë të amortizuar dhe disa raste me mungesën e ujit 24 orë.

Duke konsideruar MBZHR institucionin përgjegjës për zhvillimin bujqësor dhe rural dhe zhvillimin e sektorit të agroturizmit pjesë integrale, vlerësojmë nevojën e një sektori të dedikuar për agroturizmin, i cili do të ndihmonte jo vetëm në hartimin e politikave nxitëse për zhvillimin e agroturizmit, por edhe në implementimin e tyre dhe monitorimin e investimeve të kryera, duke zvogëluar në këtë mënyrë riskun që ekziston për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.


Nga evidenca e grumbulluar gjatë auditimit u vu re një mungesë e përgjithshme e të dhënave zyrtare kur bëhet fjalë për Shqipërinë dhe asnjë institucion publik, përfshirë INSTAT-in, MZHBR apo Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nuk po prodhon të dhëna rreth agroturizmit.

Referuar Udhëzimit 3/1 datë 15/04/2019 (MBZHR dhe MFE), MBZHR dhe AZHBR hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sa i takon numrin të aplikimeve për të përfituar nga skema kombëtare në raport me numrin e përfituesve gjendja paraqitet si më poshtë:

Viti	Nr. Aplikimeve	Nr. Përfituesve	Raporti aplikime/përfitues
2018	27	17	63%
2019	15	4	27%
2020	0	0	0%

Burimi: AZHBR



Burimi: Grupi i auditimit


Sic vihet re edhe nga grafiku numri i aplikimeve ka tendencë rënie dhe raporti mes përfituesve dhe aplikimeve të kryera është i ulët. Nga intervistimi i subjekteve që kanë përfitur nga skema kombëtare, masa e agroturizmit, të gjithë subjektet u shprehën se janë njohur me mundësitë e përfitimit nga masat mbështetëse të skemës kombëtare nëpërmjet AZHBR dhe kontakteve që kanë patur me punonjësit e këtij institucioni. Megjithëse ka patur mungesë të një plani informimi të hartuar nga MZHBR dhe AZHBR, vlen të theksohet kontributi që AZHBR ka dhënë në nxitjen e interesit të subjekteve përfituese.

Gjatë periudhës objekt auditimi 2018-2020, nëpërmjet Skemës Kombëtare të mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, rezultojnë si më poshtë:

Viti	Çelje Buxhetore	Buxheti (Lekë)	Buxheti pas Rialokimeve	Buxheti Faktik
2018	Shkresa Nr.888/1 Datë 24.01.2018	2,565,000,000	1,804,162,000	1,659,858,720
	Masat për agroturizëm	251,649,189	143,494,470	99,052,429
2019	Shkresa Nr.24/2 Datë 08.01.2019	600,000,000	711,392,000	673,805,915
	Masat për agroturizëm total	56,522,530	56,522,530	45,154,237
	Të prapambetura nga viti 2018	36,522,530	36,522,530	36,522,530
	Masat për agroturizëm 2019	20,000,000	20,000,000	8,631,707
2020	Shkresa Nr.312 Datë 15.01.2020	743,900,000	1,143,950,000	1,143,705,696
	Masat për agroturizëm total	25,000,000	9,055,386	9,045,750


Të prapambetura nga viti 2019	10,000,000	8,055,386	9,045,750
-------------------------------	------------	-----------	-----------

Burimi: AZHBR



Burimi: AZHBR

Përpunuar nga Grupi i auditimit



Burimi: AZHBR

Përpunuar nga Grupi i auditimit

Sikurse shihet edhe nga të dhënat, masat mbështetëse për zhvillimin e agroturizmit mbeten akoma në nivele të ulta. Shkaqet mbeten ende të paqarta por sigurisht mungesa e një strategjie të dedikuar për zhvillimin e Agroturizmit duke e konsideruar si një potencial të lartë për zhvillimin bujqësor rural mbetet kryesor. Synimi kryesor i politikave që nxisin zhvillimin e sektorit të agroturizmit duhet të jetë nxitja e kërkesës nëpërmjet lehtësimit të procedurave dhe evitimit të proceseve komplekse e me kosto shtesë.

Nga evidenca e grumbulluar gjatë fazës së terrenit, rezultoi se të gjithë të intervistuarit që kishin përfituar nga fondet e skemës kombëtare vlerësuan përpjekjet e bëra nga AZHBR për të nxitur interesin dhe ndihmesën që kanë marrë gjatë gjithë procesit të aplikimit, por në të gjitha rastet konfirmuan vështirësitë që kanë hasur në lidhje me aplikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, të cilat nuk mund të plotësohen pa patur ndihmë të specializuar. Në ndryshim nga masat e tjera që janë parashikuar në skemën kombëtare, të cilat kanë procedurë më të thjeshtuar për aplikimin, masa për agroturizëm duke u konsideruar si investim parashikon një sërë dokumentatash shtesë. Në këtë mënyrë subjektet që aplikojnë për masën e agroturizmit janë të detyruar ti drejtohen studiove të konsulencës për ti asistuar gjatë gjithë procesit të përgatitjes së dokumentacionit kundrejt kostove shtesë.

**Gjetje nr .6:**

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 3/1 datë 15.04.2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kapitulli IX “Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera”, pika 6, MZHBR dhe AZHBR nuk kanë hartuar një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

**Konkluzion:**

Mungesa e planit të informimit krijon mundësi për numrin e ulët të aplikimieve për përfitimin nga fondet e skemës kombëtare.

**Rekomandim nr. 6:**

MZHBR, në bashkëpunim me AZHBR, të hartojë një plan informimi për grupet e interesit, për masat e përfitimit nga skema kombëtare si përcaktohet në Udhëzimin 3/1 datë 15/04/2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kapitulli IX Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera, pika 6.

**Brenda vitit 2021**

Aplikimet për skemat e investimeve janë kryer bazuar në VKM-të përkatëse gjatë periudhës objekt auditimi VKM Nr. 72 datë 07/02/2018 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, VKM Nr. 128 datë 13.03.2019 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2019”, VKM Nr.100 datë 05.02.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten, dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2020” Udhëzimit të MBZHR dhe MFE, Nr. 1, datë 23.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe Udhëzimit nr. 2, datë 23.03.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 19.02.2018 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

Nga ana e AZHBR, bazuar në Udhëzimin e përbashkët të MBZHR dhe MFE, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, është bërë promovimi i masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural nëpërmjet:

- Takimeve informuese me grupet e interesit në nivel pushteti lokal

AZHBR në bashkëpunim me MBZHR, Drejtoritë e Bujqësisë dhe pushtetin lokal ka bërë promovimin e masave mbështetëse dhe informimin e grupeve të interesit rreth masave mbështetëse, kushteve të përfitimit dhe për procedurat që duhet të ndiqen deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

- Përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve të ndryshme promovuese

Për informimin e fermerëve mbi masat e mbështetjes të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, janë përgatitur broshura informuese nga ana e AZHBR.

- Promovimit mediatic

Informimi mediatic i publikut të gjerë, lidhur me masat e mbështetjes së programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Transmetimet e spoteve në televizione u bënë gjatë periudhës së aplikimit sipas një mediaplani të parashikuar që me nënshkrimin e kontratës.

Ngritja e Agropikave në qytete të ndryshme të Shqipërisë, ka rritur mundësinë për dhënie e informacionit sa i takon programeve mbështetëse për fermerët dhe agropërpunuesit. Çdo Agropikë është në dispozicion të qytetarëve të interesuar për të aplikuar në Skemën Kombëtare apo fondet IPARD.

Megjithë përpjekjet e bëra nga AZHBR në lidhje me informimin e të interesuarve, ato mbeten akoma në kuadrin e nxitjes së ofertës dhe jo të kërkesës.

Referuar Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit harton dhe ndërton strategji komunikimi efektive, organizon fushata promovimi dhe mediatike me qëllim dhënien e informacionit në publik.

Në këtë kontekst, SPK ka për detyrë:

- Të kryejë hulumtime për pika të forta e të dobëta në drejtim të realizimit të objektivave të AZHBR dhe ndërton strategji të përshtatshme për arritjen e këtyre objektivave
- Të krijojë dhe të ndjekë standardet e komunikimit në AZHBR qendër dhe Agropika.

SPK nuk ka hartuar një strategji komunikimi e cila do të ndihmonte procesin e informimit dhe nxitjen e kërkesës nga subjektet që mund të përfitojnë. E vetma strategji e cila vazhdon të jetë akoma draft është strategjia e komunikimit për fondet IPARD, ndërsa për skemën kombëtare nuk ekziston.

#### ***Gjetje nr. 7:***

Bazuar në Kap. II të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i Shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të AZHBR nuk ka hartuar dhe ndërtuar një strategji komunikimi.

#### ***Konkluzion:***

Mungesa e një strategjie efektive komunikimi nuk ndihmon në informimin dhe lehtësimin e subjekteve të interesuara për të përfituar nga fondet e skemës kombëtare.

#### ***Rekomandim nr. 7:***

Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të hartojë dhe ndërtojë një strategji efektive komunikimi, si përcaktohet në Kap. II të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i Shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020.

***Shtator 2021 e në vazhdim***

#### ***Gjetje nr. 8:***

Bazuar në Kap. II, pika 8 të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të AZHBR nuk ka kryer hulumtime për pikat e forta dhe të dobëta në drejtim të realizimit të objektivave të AZHBR.

#### ***Konkluzion:***

Mungesa e feedback-ut në lidhje me fondet e përdorura në sektorin e agroturizimit, krijon pengesë për perspektivën e zhvillimit të sektorit.

#### ***Rekomandim nr. 8:***

Sektori i Promocionit dhe Komunikimit, referuar Kap. II, pika 8 të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020, të ndërtojë modele anketimi për subjektet që kanë përfituar nga fondet e skemës kombëtare, në fushën e agroturizimit.

***Shtator 2021 e në vazhdim***

#### ***Gjetje nr. 9:***

Aplikantët kanë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për shkak të kriterëve të përcaktuara për masën e agroturizimit (si investim), në ndryshim nga masat e tjera mbështetëse.

#### ***Konkluzion:***

Kompleksiteti i procesit të aplikimit përbën risk për uljen e kërkesës.

#### ***Rekomandim nr. 9:***

MZHBR, në bashkëpunim me AZHBR, të shohë mundësinë e krijimit të një sektori, i cili të orientojë dhe asistojë gjithë subjektet e interesuara gjatë procesit të aplikimit.

Gjatë periudhës objekt auditimi 2018-2020, buxheti fakt i akeluar paraqitet si më poshtë:

	Buxheti i alokuar për skemën kombëtare	Buxheti i alokuar për masën agroturizëm total	Buxhet i rialokuar për investime të prapambetura nga viti paraardhës	Buxheti i alokuar masa agroturizëm viti ushtrimor	Masa agroturizëm/Skema kombëtare
2018	1,804,162,000	143,494,470		143,494,470	8%
2019	711,392,000	56,522,530	36,522,530	20,000,000	3%
2020	1,143,950,000	9,055,386	9,055,386	0	0%

Burimi informacionit AZHBR  
Përpunoi: Grupi i auditimit

Sipas të dhënave të mësipërme, pesha specifike që sektori i agroturizmit zë në totalin e ske mës kombëtare të mbështetjes, referuar buxhetit fakt paraqitet, si më poshtë:

- Për vitin 2018, përqindja (%) agroturizmi në raport me totalin rezulton 8%.
- Për vitin 2019, përqindja (%) agroturizmi në raport me totalin rezulton 3%.
- Për vitin 2020, përqindja (%) agroturizmi në raport me totalin rezulton 0%.

Në përlogaritjen e peshës specifike nuk janë marrë në konsideratë fondet e rialokuara në vitin pasardhës për shkak të mospërfundimit të investimit brenda vitit, si në rastin e vitit 2019 ku buxheti total për masën e agroturizmit përfshin edhe 36,522,530 lekë si fond i prapambetur nga viti 2018, apo viti 2020 ku buxheti i alokuar për masën e agroturizmit është totalisht fond i prapambetur nga viti 2019.

Referuar Udhëzimit 3/1, datë 15/04/2019 të MBZHR dhe MFE, Kriteret e përfitimit për masën 10, Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 30 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10,000,000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt, subjektet duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë plan biznesin e detajuar 5 vjeçar, sipas modelit standard;
- Investimi, në përfundim të tij duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse lidhur me akomodimin;
- Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndertimit/ rikonstruksionit sigurohet para lidhjes së kontrates, por jo me vonë se data 7.6.2019;
- Investimi duhet të përfundojë brenda vitit buxhetor.

Duke analizuar gjithë kompleksitetin e procesit nga momenti i publikimit të masave mbështetëse nga skema kombëtare e deri në finalizimin e gjithe procesit në fund të vitit buxhetor, faktit se fondet e përdorura për masën mbështetëse agroturizëm janë investime kohës së nevojshme që duhet për përgatitjen e planit të biznesit, procesi aplikimit, marrjes së lejes së zhvillimit, kryerjes së investimit pas lidhjes së kontratës me AZHBR, etj, konkludohet se subjektet përfituese duhet të sforcohen për të përmbyllur me sukses investimin brenda vitit buxhetor në cilësinë e kërkuar dhe në përputhje me parametrat e përcaktuar.

#### **Gjetje nr. 10:**

Afati i përcaktuar në lidhje me përfundimin e investimit brenda vitit buxhetor, në rastin e masës së agroturizmit është i pamjaftueshëm. Janë evidentuar raste të pamundësisë së

kryerjes së investimit brenda vitit ushtrimor të cilat kanë cuar edhe në hartimin e shtesë kontrate me subjektet përfituese, ku palët njohin dhe bien dakort për faktin se ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve thelbësore të kontratës, por duke gjetur të argumentuar dhe të provuar kërkesën e subjekteve kontraktore për afatin e kryerjes së investimit, përcakton se afati perfundimtar i realizimit të pagesave të mbartura do të jetë 6 mujori I i vitit pasardhës.

**Konkluzion:**

Afatet e limituara përbëjnë risk për përmbylljen e investimit në cilësinë e kërkuar.

**Rekomandim nr. 10:**

MZHBR, në bashkëpunim me MFE, të konsiderojë mundësinë e rishikimit të marrëveshjes dypalëshe për shtyrjen e aftatit të përfundimit të investimit për masat mbështetëse në agroturizëm, duke bërë të mundur kalimin e fondit në llogarinë 231 (investime) dhe jo në llogarinë 606.

*Brenda vitit 2021*

**4.2.2 A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizmit dhe a janë arritur rezultatet e synuara?**

MBZHR, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ka për mision konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe reformës legjislative në këtë sektor<sup>15</sup>.

Nëpërmjet skemës kombëtare, për periudhën objekt auditimi, janë përfituar 153,252,416 lekë nga 21 subjekte që kanë investuar në agroturizëm.

Sipas VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, pika 5/e Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka për detyrë:

- Të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural<sup>16</sup>.

**Gjetje nr. 11:**

MZHBR nuk ka kryer asnjë monitorim në investimet e kryera në sektorin e agroturizmit nëpërmjet skemës kombëtare. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë fazës së terrenit nuk ka evidencë të raportimeve periodike nga AZHBR për MZHBR që lidhen me zhvillimin e sektorit të agroturizmit. Mungesa e monitorimit të investimeve të kryera në sektorin e agroturizmit, mund t'i krijojë vizion jo të qartë politikëbërjes në strategjinë e zhvillimit të agroturizmit si pjesë integrale e zhvillimit rural.

**Konkluzion:**

Mungesa e monitorimit të fondeve të përdorura për agroturizmin nuk lejon të matet efektiviteti i politikave të ndjekura në realizimin e qëllimit kryesor, atë të zhvillimit rural.

**Rekomandim nr. 11:**

MZHBR të vlerësojë mundësinë e kryerjes së monitorimeve mbi investimet e kryera në sektorin e agroturizmit, në funksion të nxitjes së punësimit, rritjen e të ardhurave dhe nxitjen e zhvillimit të ekonomisë rurale.

*Brenda vitit 2021*

Referuar Rregullores së Brendshme të AZHBR nr. 97/1 prot., datë 21.02.2019:

**Neni 14 pika 14.3**

Detyrat e Drejtorit të Kontrollit janë:

<sup>15</sup> Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR Nr. 1984 datë 27/02/2019, Neni 2

<sup>16</sup> VKM nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, pika 5/e

Organizimi dhe menaxhimi i sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit<sup>17</sup>.

#### **Neni 14 pika 14.6.1**

Detyrat e Përgjegjësit të Monitorimit të skemave janë:

- Përgatitja e urdhrave të punës, programeve dhe autorizimeve për kontrollet që do të monitorohen në terren<sup>18</sup>.
- Analizimi dhe argumentimi i rezultateve të kontrolleve të ushtruara

Referuar Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit nr. 1021/1 prot., datë 16.07.2018, nr. 1329 prot., datë 25.04.2019 dhe nr. 1745 prot., datë 19.06.2020, ku përfshihet edhe skema e agroturizmit, Sektori i Monitorimit, kryen kontrolle pas financimit (ex-post), si më poshtë:

- Monitorimi i aplikantëve përfitues në këto skema bëhet nga Sektori i Monitorimit për një periudhë 5 vjecare nga pagesa e fundit<sup>19</sup>;
- SM në fillim të cdo viti bazuar në metodologjinë e peshës së riskut përgatit listën e projekteve që do ti nënshtrohen kontrollit pas financimit;
- Lista e projekteve që do ti nënshtrohen kontrollit pas financimit firmoset nga Përgjegjësi i SM, Drejtori i Kontrollit dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR.

Bazuar në Manualin e Procedurave për zbatimin e skemave kombëtare, ku përfshihet edhe skema e agroturizmit, Sektori i Monitorimit harton sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, numrin total të subjekteve për monitorim në terren, me proritë riskun realizohen vizitat në terren, ku bazuar edhe në kushtet sipas kontartës së Grantit të përfituesit me AZHBR-në Sektori i Monitorimit kryen kontrolle ex-post të paktën një herë në pesë vite. Monitorohet vazhdueshmëria dhe qëndrueshmëria e aktivitetit të përfituesit sipas termave të kontratës dhe parashikimeve të parashtruara në Biznes Plan.

Masat mbështetëse për agroturizëm, duhet të monitorohen në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës 5 vjecare pikërisht sepse janë fonde të përfituara për investime të kryera bazuar në plan biznesi me indikatorë konkretë të matshëm. Mungesa e monitorimeve të vazhdueshme përbën risk të lartë për mospërmbushjen e treguesve të planit të biznesit.

#### **Gjetje nr. 12:**

Në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit, nuk është e përcaktuar metodologjia që do të përdoret për matjen e kriterëve dhe mënyrën se si do të monitorohen investimet.

#### **Konkluzion:**

Mungesa e përcaktimit qartë të frekuencës së kontrolleve që duhet të ushtrohen në subjektet përfituese pas financimit, nuk ndihmon në vlerësimin e impaktit që kanë fondet në zhvillimin e agroturizmit.

#### **Rekomandim nr. 12:**

AZHBR të vlerësojë mundësinë e përfshirjen në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit, të metodologjisë së monitorimit të investimeve.

**Brenda vitit 2021**

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara Sektori Monitorimit pranë Drejtorisë së Kontrollit nuk ka kryer asnjë inspektim për gjithë periudhën objekt auditimi 2018-2020. Nga evidenca e grumbulluar si edhe nga përgjigjet e intervistave rezulton se Sektori i Monitorimit pranë

<sup>17</sup> Rregullore e Brendshme AZHBR nr. Prot.97/1 datë 21.02.2019 Neni 14 pika 14.3

<sup>18</sup> Rregullore e Brendshme AZHBR Nr. Prot.97/1 datë 21.02.2019 Neni 14 pika 14.6.1

<sup>19</sup> Manuali i Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr. 1745 datë 19.06.2020

Drejtorisë së Kontrollit nuk ka plane pune të miratuar për çdo vit, sic përcaktohet edhe në Manualin e Procedurave. Gjithashtu duke qenë se të gjitha subjektet përfituese të fondeve nga skema kombëtare, si pjesë të dokumentacionit kualifikues kanë plan biznesi me indikatorë të matshëm, mungesa e monitorimeve dhe raporteve që prodhojnë ato, analizimi i të dhënave të monitorimit, nuk mund të kryhet vlerësimi i impaktit që ka përdorimi i fondeve në zhvillimin e biznesit të agroturizmit.

Nga shqyrtimi i analizave vjetore të AZHBR për periudhën 2018-2020, sektori i agroturizmit nuk përmendet përveçse të dhënave që raportohen për përdorimin e fondit të skemave kombëtare.

Sipas përgjigjeve të pyetësorëve drejtuar AZHBR: “Gjatë periudhës së auditimit nuk është monitoruar asnjë agroturizëm, janë parashikuar në vazhdim sipas planit të miratuar në përmbushje të kërkesave të manualit brenda afatit 5 vjeçar”.

Referuar Raportit të Auditimit të Brendshëm AZHBR nr. 2331/4 prot., datë 31.08.2018, “Efektiviteti i granteve – Monitorimi dhe qëndrueshmëria e projekteve”, rezultojnë gjetje, si më poshtë:

- Te analizimi i burimeve njerëzore, përfshirë çështje rregullatore dhe të logjistikës së nevojshme, së bashku me indekset e performancës, për skemat kombëtare, performanca ka qenë e limituar dhe jo gjithëpërfshirëse, si në vite ashtu edhe në numër projektesh.
- Te analiza e gjithë procedurës së granteve nuk ka një kalendar për kryerjen e monitorimeve dhe një metodologji për përcaktimin e kritereve për mënyrën se si do të monitorohen investimet.

Në lidhje me gjetjet e mësipërme nga ana e Sektorit të Auditit të Brendshëm janë lënë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat vazhdojnë të mos gjejnë zbatim.

Në raportimet që Sektori i Monitorimit ka kryer gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë mungesa të burimeve njerëzore për të përballuar numrin e lartë të monitorimeve.

#### **Gjetje nr. 13:**

Në Manualin e Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit, nuk është përcaktuar qartë frekuenca e monitorimeve që duhet të kryhen në subjektet përfituese nga masa e agroturizmit brenda afatit 5 vjeçar.

#### **Konkluzion:**

Mungesa e një metodologjie të mirëpërcaktuar bart riskun e kontrolleve fiktive.

#### **Rekomandim nr. 13:**

AZHBR të përcaktojë në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit numrin e kontrolleve/monitorimeve që duhet të kryhen pas financimit brenda periudhës 5 vjeçare.

**Brenda vitit 2021**

#### **Gjetje nr. 14:**

Drejtorja e Kontrollit në AZHBR, në kundërshtim me nenin 14, pika 14.3 e Udhëzimit Nr. 13, datë 15.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, nuk ka kryer detyrat, si më poshtë:

- Organizimi dhe menaxhimi i sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit
- Aprovimi i programeve të punës dhe programeve të kontrolleve konceptuar nga përgjegjësit e Kontrollit dhe Monitorimit
- Kontrolli i punës dhe zbatimi i detyrave që ju ngarkohen përgjegjësve të sektorëve dhe inspektorëve të kontrollit
- Në rastet e parregullsive dhe performancës së ulët në punë nga përgjegjësit dhe inspektorët vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm dhe propozon marrjen e masave administrative sipas legjislacionit në fuqi.

**Konkluzion:**

Mungesa e organizimit dhe menaxhimit krijon risk për funksionimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të sektorëve.

**Rekomandim nr. 14.1:**

Drejtoria e Kontrollit të organizojë dhe menaxhojë punën e Sektorit të Monitorimit.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**Rekomandim nr. 14.2:**

Drejtoria e Kontrollit duhet të miratojë planin e kontrolleve që do të kryhen në subjektet përfituese nga masa e agroturizmit, bazuar në analizën e riskut të kryer në bashkëpunim me Sektorin e Riskut, dhe jo bazuar në analizën e riskut të Sektorit të Monitorimit.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**Rekomandim nr. 14.3**

Drejtoria e Kontrollit të kontrollojë punën dhe zbatimin e detyrave që i ngarkohen Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit dhe të raportojë te Drejtori i Përgjithshëm në rast të parregullsive dhe performancës së ulët.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**Gjetje nr. 15:**

Sektorin e Monitorimit nuk ka përgatitur listën e projekteve që do t'i nënshtrohen kontrollit pas financimit, nuk ka hartuar programin e punës dhe nuk e ka firmosur e miratuar si përcaktohet në Manualin të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr. 1745, datë 19.06.2020, Kapitulli B "Procedurat e Kontrollit në terren për skemat e investimeve", iv. Kontrollin pas financimit (ex-post), pika 2, 3 dhe 4.

**Konkluzion:**

Mungesa e planifikimit të listës së projekteve që do të monitorimeve përbën risk për garantimin e rezultateve të pritshme.

**Rekomandim nr. 15:**

Sektorin e Monitorimit të hartojë planin e punës, listën e projekteve që do të nënshtrohen kontrollit pas financimit për gjithë subjektet përfituese nga skema kombëtare, masa agroturizëm dhe ta paraqesë për miratim te Drejtori i Kontrollit.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**Gjetje nr. 16:**

Sektorin e Monitorimit nuk ka kryer asnjë monitorim për fondet e përdorura nga skema kombëtare në masën e agroturizmit, përgjatë viteve 2018-2020.

**Konkluzion:**

Nisur nga vlera e granteve, veçoritë e masës së agroturizmit, faktin që plani i biznesit i dorëzuar gjatë aplikimit ka indikatorë vjetorë të matshëm, si dhe riskun për ecurinë si duhet të agroturizimeve, duke qenë se është një sektor në fillimet e veta, duhet të përbëjnë mjaftueshëm risk për t'u trajtuar ndryshe nga masat e tjera të përfitimit nga skemat kombëtare, sa i përket monitorimit.

Mungesa e monitorimit të fondeve të përdorura për agroturizmin nuk lejon të matet impakti që duhet të sjellë në zhvillimin e sektorit dhe krijon mundësi për tjetërsimin e aktivitetit ose mos matjes së indikatorëve të planit të biznesit.

**Rekomandim nr. 16:**

AZHBR, nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të planifikojë numrin e monitorimeve në subjektet përfituese të masave që konsistojnë në investime, duke ndjekur indikatorët e përcaktuar në planin e biznesit.

*Brenda vitit 2021*

**Gjetje nr. 17:**

Sektori i Monitorimit ka burime njerëzore të pamjaftueshme për të përballuar numrin e lartë të kontrolleve në terren.

**Konkluzion:**

Mungesa e burimeve njerëzore cënon ushtrimin me përgjegjësi të detyrave nga ana e SM.

**Rekomandim nr. 17:**

AZHBR të përlogarisë numrin e punonjësve që duhen shtuar në SM, me qëllim mbulimin më me efektivitet të monitorimeve, dhe të kryejë ndryshimin e strukturës.

Janar 2022

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit, mbi rekomandimet e mësipërme, nga subjekti i audituar MBZHR është paraqitur observacioni me nr. 204/6 prot., datë 19.08.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit:**

*Lidhur me rekomandimin e gjetjes Nr. 11 mendojmë se i takon AZHBR dhe jo MBZHR.*

**Qendrimi i grupit të auditimit:**

*Opinionin e subjektit si citohet në observacionin nr. 204/6 prot., datë 19.08.2021, nuk shpreh kundërshtitë me gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit, mbi rolin e monitorimit në përmirësimin dhe politikëbërjes për zhvillimin rural.*

## 5. PËRMBLEDHJE

### Mesazhi i auditimit

Sektori i Agroturizmit është një risi e viteve të fundit në ekonominë rurale në Shqipëri. Ai shihet si një sektor me potencial dhe zhvillimi i tij është parë me prioritet nga mekanizmat shtetërorë.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020, si dokumenti më i lartë politik për zhvillimin bujqësor dhe rural, nuk ka përcaktuar objektiva për zhvillimin e agroturizmit. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, ose siç njihet ndryshe Programi i 100 fshatrave, ishte një hap pozitiv për zhvillimin e sektorit të agroturizmit. Në atë program gjendeshin objektiva që lidheshin me agroturizmin, sidoqoftë nuk pati asnjë monitorim nga ana e MBZHR për arritjen e këtyre objektivave. VKM nr. 22, datë 12.01.2018, jep një përkufizim të agroturizmit, si dhe përcakton kriteret për certifikimin si “agroturizëm”. Në këtë fazë ende fillestare të zhvillimit të agroturizmit, nevojitet një strategji e mirëfilltë dhe një ligj i posaçëm për agroturizmin, ku të përcaktohen objektiva të matshme, të hartohet plan veprimi për zbatimin e tyre, si dhe të ketë një ndarje të qartë të detyrave, roleve e përgjegjësive ndërmjet aktorëve të përfshirë, me qëllim që të garantohet zhvillimi i qendrueshëm i këtij sektori.

Politikat e deritanishme për zhvillimin e agroturizmit kanë konsistuar vetëm në dhënien e granteve nga skema kombëtare për mbështetjen e agroturizmit, për të cilat, përgjatë 2018 – 2020, nuk ka patur monitorime as nga AZHBR e as nga MBZHR. Nga vizitat në terren të subjektet e certifikuar si “agroturizëm”, problematikat kryesore të sipërmarrësve lidheshin me mungesën e infrastrukturës së përshtatshme rrugore, pajisjes me energji elektrike dhe ujë të pijshëm dhe vështirësinë në gjetjen e burimeve njerëzore të kualifikuara për të plotësuar stafin. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se MBZHR dhe AZHBR nuk administrojnë të dhëna e statistika mbi sektorin e agroturizmit (të dhëna të cilat nuk gjenden as te INSTAT), si psh numrin e të punësuarve në këtë sektor, numrin e turistëve që frekuentojnë agroturizmin, ndikimin që agroturizmi ka në ekonominë rurale ose çdo të dhënë tjetër të ngjashme që mund të ndihmojë në pasjen e një tabloje më të qartë të zhvillimit të agroturizmit, që do të ndihmonte për të kuptuar situatën aktuale të këtij sektori dhe, sigurisht, në hartimin e politikave më konkrete e të qëndrueshme.

Mënyra e vetme për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm të agroturizmit dhe për të shfrytëzuar potencialin që ky sektor ka është angazhimi ndërinstitucional.

Auditimi i performancës me temë “Ekonomia rurale me fokus Agroturizmin” u zhvillua në një fazë fillestare të sektorit të agroturizmit, i cili konsiderohet me potencial të madh në vendin tonë. Ky është një moment kyç në hedhjen e themeleve të zhvillimit të këtij sektori. Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020 nuk e përmend më shumë se 3 herë termin “agroturizëm” dhe nuk ka objektiva të parashikuara për atë sektor. Fenomeni i agroturizmit ka hyrë rishtaz në realitetin shqiptar dhe vetëm në vitin 2018 ka marrë një përkufizim në VKM nr. 22, datë 12.01.2018 “Për certifikimin e veprimtarisë së Agroturizmit”, ku përkufizohet si “*veprimtaria pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulurore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor*”. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, siç njihet Programi i 100 fshatrave, është një hap pozitiv i ndërmarrë në drejtim të zhvillimit të agroturizmit. Në këtë program percaktohen disa objektiva të matshme, që lidhen me agroturizmin, sidoqoftë, kjo shtesë në strategji nuk u shoqërua as me plan veprimi e as me monitorime. Strategjia dhe baza ligjore që rregullon zhvillimin e sektorit të agroturizmit nuk ka një ndarje të qartë detyrash mes aktorëve, çka cënon zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori, për të arritur potencialet që ka. Një strategji dhe një bazë ligjore e mirëfilltë për mbështetjen e zhvillimit të agroturizmit do të përcaktonte qartë rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve, duke nisur me politikëbërjen, infrastrukturën mbështetëse, kapacitetin e burimeve njerëzore e deri te mbajtja e statistikave e të dhënave të sakta mbi agroturizmin.

Çdo vit, miratohet një VKM “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Sa i përket procesit të aplikimit për përfitim nga fondet e skemave kombëtare në masën e agroturizmit, AZHBR ka për detyrë:

- i) Ofrimin e shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në seli dhe në terren;
- ii) Orientimin e veprimtarisë së fermerëve në përputhje me drejtimit e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- iii) Zhvillimin e procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme.

Në procesin e aplikimit, disa nga problematikat që janë konstatuar janë, si më poshtë:

- a) Në ndryshim nga masat e tjera, për të cilat aplikimi kryhet online, për masën e agroturizmit, dokumentacioni që duhet dorëzuar është fizik dhe shumë voluminoz. Në takimet që kemi zhvilluar gjatë fazës së terrenit me subjekte përfitues nga këto фонде, pothuajse të gjithë thonin se u ishin drejtuar studiove të caktuara për plotësimin e dokumentacionit. Vështirësia në plotësimin e dokumentacionit krijon vështirësi në akses për “*target group*”-in e synuar. Në rregulloren e brendshme të AZHBR, asistenca për plotësimin e dokumentacionit është përgjegjësi e Agropikave, por ajo konsiston në masat e tjera të përfitimit nga skemat kombëtare, që kërkojnë dokumentacion bazik dhe kryesisht deklarues dhe jo masës së agroturizmit, që kërkon përgatitje profesionale të lartë. Për këtë, kemi rekomanduar që, AZHBR të përcaktojë një instancë tjetër që do të asistojë në plotësimin e dokumentacionit për masën e agroturizmit, me qëllim lehtësimin e aksesit të aplikantëve ndaj kësaj mase të skemës kombëtare;
- b) Masa e bujtinave/ agroturizmit trajtohet njësoj me masat e tjera, kur bëhet fjalë në lëvrimin e fondeve. Subjekti përfitues, që nga momenti i shpalljes fitues, ka kohë deri në 31.12 të vitit aktual për të përfunduar të gjithë investimin, që në rastin e agroturizmit mund të shkojë deri në 20,000,000 lekë (granti nga skema kombëtare në masën 50% të investimit, maksimumi 10,000,000 lekë). Ky investim duhet të bëhet për një periudhë

jo më të gjatë se 3-4 muaj dhe të konfirmohet nga Drejtoria e Kontrollit. Vetëm atëherë, bëhet autorizimi për pagesë. Afatet e limituara përbëjnë risk për cedim në cilësinë e punimeve dhe, në rastin më të keq, edhe për djegien e fondeve.

Sa i përket monitorimit të këtyre fondeve, AZHBR nuk ka kryer asnjë monitorim për fondet e përdorura nga skema kombëtare në masën e agroturizmit, përgjatë viteve 2018-2020. Nisur nga vlera e granteve, veçoritë e masës së agroturizmit, faktit që plani i biznesit i dorëzuar gjatë aplikimit ka indikatorë vjetorë të matshëm, si dhe risku për ecurinë si duhet të agroturizmeve, duke qenë se është një sektor në fillimet e veta, duhet të përbëjnë mjaftueshëm risk për t'u trajtuar ndryshe nga masat e tjera të përfitimit nga skemat kombëtare, sa i përket monitorimit. As MBZHR nuk ka kryer asnjë monitorim mbi investimet që janë kryer në sektorin e agroturizmit. Mungesa e monitorimit të “*feedback*” të këtyre fondeve të përdorura për agroturizmin nuk mundëson matjen e impaktit që këto investime kanë sjellë në qëllimin final zhvillimin e ekonomisë rurale dhe efektivitetin që politikat kanë patur.

Rekomandimet nga grupi i auditimit janë lënë specifike për secilin subjekt, duke u përpjekur të rregullojë kornizën ekzistuese për zhvillimin e sektorit të agroturizmit, si në nivel politikëbërje, ashtu edhe në nivel zbatimi politikash. Mënyra e vetme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori është duke siguruar që në hapat e para një terren të përshtatshëm zhvillimi.

## **6. GRUPI I PUNËS**

Delor Prosi, Përgjegjës Grupi;

Eva Kushta, anëtare;

Anesti Gjika, anëtar.